



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

**RAPORT KRAHASIMOR MBI
SITUATËN E RESPEKTIMIT TË
TË DREJTAVE
DHE LIRIVE TË NJERIUT
NË SHQIPËRI**

2022-2023

DHJETOR 2023



www.ahc.org.al



[komiteti shqiptar i helsinki](https://www.facebook.com/komiteti.shqiptar.i.helsinki)



[albanianhelsinkicommittee](https://www.instagram.com/albanianhelsinkicommittee)

**RAPORT KRAHASIMOR MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE
DHE LIRIVE TË NJERIUT
NË SHQIPËRI
PËR VITET 2022 - 2023**

Tiranë, Dhjetor 2023

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Jo Korrupsionit, Po Demokracisë”, mbështetur financiarisht me fonde të Qeverisë Suedeze.



Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Qeverisë Suedeze, apo të komunitetit të donatorëve e partnerëve.

Kontribuan në hartimin e këtij raporti (renditur sipas rendit alfabetik):

1. *Znj. Anda Kruetani, Koordinatore Projektsh, KShH*
2. *Znj. Ardita Kolmarku, Drejtuese e Klinikës së Ligjit/Menaxhere Projektsh, KShH*
3. *Znj. Ardita Matlija, Asistente Projektsh, KShH*
4. *Znj. Enegrida Bënja, Asistente Projektsh, KShH*
5. *Z. Erdion Maçolli, Avokat, KShH*
6. *Znj. Eriselda Ndreca, Paraligjore/Asistente Projektsh, KShH*
7. *Znj. Nosiana Burnazi, Paraligjore/Asistente Projektsh, KShH*
8. *Znj. Rabije Zika, Paraligjore/Asistente Projektsh, KShH*
9. *Znj. Servete Çeka, Paraligjore/Koordinatore Projektsh, KShH*

Rishikuan dhe edituan:

1. *Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH*
2. *Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH*

Përktheu: Z. Guri Lekloti, Përkthyes

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt”
Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752
Tel: 04 2233671
Mob: 0694075732
E-mail: office@ahc.org.al
Website: www.ahc.org.al

PËRMBAJTJA E PUNIMIT

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

	7
1 Angazhimi qytetar dhe i shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse dhe ligjvënëse	12
2 Ndikimi i korrupsionit tek të drejtat dhe liritë e njeriut dhe demokracia në tërësi	13
3 Reforma në Drejtësi	15
3.1 Eficienca gjyqësore dhe sfidat e organeve të qeverisjes së drejtësisë	16
3.2 Eficienca dhe standardet e vendimmarrjes së institucioneve të vettingut	17
4 E drejta për të zgjedhur e për t'u zgjedhur gjatë dy proceseve zgjedhore 2022-2023	18
5 Të drejtat pronësore	20
6 E drejta për arsim	21
7 Të drejtat e personave të ndodhur në kushtet e privimit të lirisë	22
8 Të drejtat e njeriut në institucionet penitenciare	22
8.1 Mbipopullimi	23
8.2 Kushtet infrastrukturore	23
8.3 Mekanizmi kërkesë-ankesë	24
8.4 Ri-integrimi dhe rehabilitimi	25
8.5 Të drejtat e personave me probleme të shëndetit mendor	26
8.6 Të miturit në konflikt me ligjin	27
8.7 Advokimi me institucionet e sistemit penitenciar	27
9 Monitorimet e kryera në Komisaritet e Policisë	28
9.1 Mbipopullimi	28
9.2 Kushtet infrastrukturore	28
9.3 Afatet dhe të drejtat procedurale të shtetasve të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar në flagrancë	29
9.4 Advokimi me institucionet e Policisë së Shtetit	29
10 Të drejtat e azilkërkuesve dhe migrantëve	30
11 Lufta kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm	32
12 Gjuha e urrejtjes së grupeve të margjinalizuara	32
13 Liria e Organizimit	33
14 E drejta për Informacion	34
15 Liria e shprehjes	35
15.1 Liria e Medias dhe të drejtat e gazetarëve në vendin e punës	35
16 Përfaqësimi ligjor falas i shtetasve pranë Gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare	36

SHKURTESAT

AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AMP	Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
BE	Bashkimi Evropian
CPT	Komiteti për Parandalimin e Torturës
DPPSh	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJKKO	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
IEVP	Institucion i Ekzekutimit të Vendimeve Penale
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
IM	Instituti i të Miturve Kavajë
IMT	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit
KDIMDHP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KE	Komisioni Evropian
KEDNJ	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KPA	Komisioni i Posaçëm i Apelit
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KShH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
MD	Ministria e Drejtësisë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
QSUT	Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza
IML	Instituti i Mjeksisë Ligjore
RSH	Republika e Shqipërisë
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar
UPR	Rishikimi Periodik Universal
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I/E dashur lexues/e,

Rritja e regjimeve hibride të qeverisjes me elementë autokratikë apo krizat e rënda humanitare të krijuara nga konfliktet ushtarake sikurse është agresioni i paprecedentë Rus ndaj Ukrainës apo konflikti i fundit midis Hamasit dhe Izraelit, duke shkaktuar kriza të rënda humanitare dhe humbje masive në jetë njerëzore, kane ndikuar në përkeqësimin e të drejtave dhe lirive të njeriut anembanë globit.

Qeveritë që nuk arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre ligjore për të mbrojtur të drejtat e njeriut në shtëpi mbjellin farat e pakënaqësisë, paqëndrueshmërisë dhe përfundimisht krizës¹.

Në Shqipëri, përveç ndikimit të pashmangshëm të faktorëve global, kriza politike këto dy vite ka sjellë polarizim të tejskajshëm, gjuhë të paprecedentë urrejtje dhe konflikte të vazhdueshme në parlament si dhe mungesë dialogu, shumë i rëndësishëm për demokracinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të reformave. Si rrjedhojë, kjo situatë ka dëmtuar vlerat e demokracisë, si toleranca, gjithëpërfshirja, transparenca, llogaridhënia dhe njëkohësisht ka përkeqësuar gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Vitet 2022-2023 shënuan sfida dhe zhvillime kritike për situatën e të drejtave të njeriut dhe shtetin e së drejtës, çka reflektoi edhe në veprimtarinë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH-së), e cila në disa raste ndeshi me pengesa në ushtrimin e misionit të saj.

Ky raport mbi respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri për vitin 2022-2023 synon informimin e publikut, institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare të akredituara në vendin tonë, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së autoriteteve publike për forcimin e kulturës së ligjshmërisë, transparencës, parimit të qeverisjes së hapur dhe përmirësimin e veprimtarisë së tyre për një mbrojtje dhe respektim më të mirë të të drejtave themelore të njeriut.

Kontributi i KShH përgjatë viteve vijon të jetë i orientuar drejt cilësisë dhe impaktit konkret për njerëzit duke pasur kryesisht në fokus pjesëmarrjen e publikut në procese vendimmarrëse, ofrimin e opionencës ligjore për nisma të rëndësishme politikbërëse dhe legjislative, luftën dhe parandalimin e korrupsionit, monitorimin e zbatimit të reformës në drejtësi, zgjedhjet e lira dhe të ndershme, ndjekjes dhe përfaqësimit të rasteve në gjykatat vendase, Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, monitorimit proaktiv të respektimit të të drejtave të njeriut nga organet e administratës publike dhe sistemit gjyqësor, me fokus të veçantë të drejtat mjedisore, mbrojtjen nga diskriminimi dhe avancimin e situatës së të drejtat e grupeve të marginalizuara të shoqërisë, parandalimin e fenomeneve të dëmshme për shoqërinë sikurse është ekstremizmi i dhunshëm, përmirësimin e transparencës së institucioneve, lirinë e shprehjes dhe median e lirë, lirinë e organizimit.

¹ Nga sulmet e qëllimshme të presidentit rus Vladimir Putin ndaj civilëve në Ukrainë dhe burgu i hapur i Xi Jinping për ujqurët në Kinë, deri tek vënia e miliona afganëve nga talebanët në rrezik nga uria.

<https://www.hrw.org/world-report/2022>

Forca reaguese dhe natyra proaktive e veprimtarisë së KShH-së ka vijuar të ndihet në opinionin publik, falë mbulimit në median e shkruar dhe elektronike, aktivizmit të shtuar në median sociale dhe shtrirjes së veprimtarisë së organizatës në zona të ndryshme të vendit.

Burimet për të konkluduar lidhur me gjendjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut në vendin tonë janë të larmishme. Por KShH është ndalur në mënyrë të veçantë në këtë raport në të dhënat që ka përfutuar në sajë të veprimtarisë së tij, veçanërisht në misionet e monitorimit të cilat realizohen bazuar në metodologji të mirëfillta dhe me vëzhgues të trajnuar, objektiv dhe profesional, në çështjet që organizata ka përfaqësuar me stafin ligjor të specializuar pranë Institucioneve të Pavarura, gjykatave vendase, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, në raporte të ndryshme studimore dhe kërkimore përgjatë kësaj periudhe, në korrespondencën dhe kontaktet që ka patur me institucionet dhe vlerësimin e reagimit të tyre.

Gjej rastin të shpreh mirënjohjen e thellë dhe të falënderoj për mbështetjen e dhënë për realizimin e veprimtarisë së KShH-së, anëtarët e Asamblesë së organizatës, stafin ekzekutiv, rrjetin e korrespondentëve, konsulentët e jashtëm dhe vëzhguesit e përkushtuar dhe të palodhur, organizatat partnere, Komitetet e Helsinkit simotra në rajon dhe më gjerë, si dhe donatorët që kanë mbështetur financiarisht veprimtaritë e organizatës, si Ambasadat e SHBA-së, Britanike, e Vendeve të Ulëta në Shqipëri, Kanadeze, Komisioni Evropian, Fondacioni Sigrid Rausing Trust, GCERF si dhe institucionet publike që kanë bashkëpunuar me ne përgjatë këtyre dy viteve.

Sinqerisht,

Erida Skëndaj
Drejtore Ekzekutive

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pjesëmarrja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse të Kuvendit rezultojnë pothuajse e munguar, çfarë ka zbehur këto dy vite potencialin për një sistem qeverisje gjithëpërfshirës dhe të hapur. KShH vëren mungesë të reagimit sistematik nga Kuvendi, për t'i dhënë përgjigje kauzave të përcjella me anë të peticioneve dhe nismave legjislative të të rinjve të asistuar nga KShH, ndërkohë që Grupi i Deputetëve 'Miqtë e Fëmijëve' ka treguar interes, duke zhvilluar seanca të veçanta dëgjimore lidhur me to. Nga ana tjetër, Ekzekutivi kryesisht i konsulton nismat ligjore me anë të Platformës së Konsultimit Publik, e cila nuk është gjerësisht e aksesueshme.

KShH vëren një rënie të ndjeshme të kërkesave për konsultim me nismë të vetë Komisionit Parlamentar të Ligjeve që mbulon çështjet e të drejtave të njeriut, si dhe mungesë të konsultimit të raporteve vjetore të institucioneve të pavarura. Në kundërshtim me parimin e barazisë para ligjit, Parlamenti i jep prioritet shqyrtimit të nismave të propozuara nga Ekzekutivi në Programet e Punimeve të tij, duke krijuar një praktikë jo të barabartë në raport me nismat ligjore të deputetëve dhe ato të zgjedhësve.

KShH vlerëson si pozitiv veprimtarinë e Institucioneve të Specializuara të Drejtësisë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK dhe GJKKO), të cilat po hedhin bazat e para në përbushje të objektivit për shpërbërjen e mitit të pandëshkueshmërisë së zyrtarëve të nivelit të lartë të akuzuar për korrupsion. Të dhënat e procedimeve të SPAK nxjerrin në pah një besim të shtuar të denoncuesve në misionin dhe veprimtarinë e SPAK-ut për goditjen pa kompromis të korrupsionit, ndërkohë që i njëjti besim nuk reflektohet tek prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm.

Paralelisht me ndëshkimin është shumë i rëndësishëm edhe parandalimi që kërkon forcimin e integritetit të institucioneve publike, përfshi ato arsimore, biznesit, medias, shoqërisë civile.

Si rrjedhojë e efekteve të Hartës së Re Gjyqësore, 18 gjykata rezultojnë të shkrira ose 47.3 % e gjykatave, duke sjellë një zhvillim të paprecedentë në raport me hartat gjyqësore të vendeve në rajon dhe të vetë BE-së. Me hyrjen në fuqi të saj, kostot e shërbimit avokator janë rritur në masën 50%-200% të tarifave të mëparshme, ndërkohë që atyre iu shtohen edhe kostot tepër të larta transporti për ndjekjen e seancave nga avokatët e rretheve pranë gjykatave të reja.

KShH vlerëson se integriteti etiko-profesional i anëtarëve të Këshillave (KLGJ dhe KLP) si dy organe të rëndësishme të qeverisjes së drejtësisë duhet të fuqizohet. Të dhënat e bëra publike për anëtarë prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, të emëruar në të njëjtën prokurori, me lidhje familjare midis tyre dhe me funksionarë të Kuvendit, cenojnë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Në një vend të vogël si Shqipëria, nuk duhet të harrojmë edhe për shumë vite, shkaqet që detyruan vendin të reformonte sistemin e drejtësisë duke përfshirë këtu ndikimet e papërshtatshme në sistemin gjyqësor nga dy pushtetet e tjera.

Edhe pse në vitin e gjashtë të vendimmarrjeve të vettingut, rezultatet pozitive të tij për pastrimin e sistemit të drejtësisë u shfaqën më së shumti në sferën administrative dhe ato nuk i shërbyen mjaftueshëm prokurorisë në drejtim të vendosjes efektive para përgjegjësisë penale të subjekteve të korruptuar dhe me pasuri ndjeshme të pajustificueshme.

Për KPK-në është prioritet përfundimi i procesit brenda afatit të ri kushtetues pasi disponon vetëm një vit deri në përmbushje të këtij afati. Për një subjekt, nga koha e shortimit deri në përfundim të procesit të shqyrtimit të ankimit pranë KPA (nëse ka patur), procesi i rivlerësimit zgjat rreth 4 vjet. Këto subjekte, deri sa vendimi të marrë formë të prerë në KPA trajtohen financiarisht në masën 75% të pagës, çka përbën një kosto të lartë financiare për buxhetin e shtetit.

Monitorimi nga vëzhguesit e KShH-së të zgjedhjeve vendore (të pjesshme në 2022 dhe ato të plota në 2023) evidentoi problematika sistemike të mbartura, si shpërdorim të aseteve publike, raste të votimit familjar, pretendime për shitblerje votash, disa prej të cilave në hetim nga prokuroria. Me keqardhje konstatojmë se, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore vazhdon të mos funksionojë. Gjithashtu, është e papranueshme në një shtet ligjor që prej afro një viti, vendimi i Gjykatës Kushtetuese vijon të mbetet i paekzekutuar sa i takon detyrimit që ka Kuvendi për plotësimin e boshllëkut ligjor që mundëson ushtrim efektiv të së drejtës kushtetuese të votës së emigrantëve.

Përgjatë këtyre dy viteve, KShH ka realizuar 26 misione monitorimi tematik dhe sporadik në institucionet e mbyllura.

Është pozitiv fakti se disa prej burgjeve më problematike në vend janë mbyllur gjatë vitit 2022. Ndërkohë, në disa nga burgjet ekzistuese të monitoruara vijojnë të konstatohen kushte të amortizura infrastrukturore, mungesë të Rregulloreve të reja të brendshme, në disa raste mbipopullim. Shqetësuese sa i takon infrastrukturës mbeten dy godinat IEVP Shënkoll, të përshtatura për akomodimin e pacientëve nën masë mjekësore, ndërkohë që këta shtetas sipas vendimit të GJEDNJ-së Strazimiri kundër Shqipërisë duhet të akomodoreshin në një institucion të posaçëm mjekësor. Edhe ky vendim i GJEDNJ është i pazbatuar.

Gjatë vitit 2023, 3 nga rastet e monitoruara sporadikisht në sistemin e burgjeve kanë të bëjnë me humbjen e jetës së tre shtetasve të privuar nga liria, një prej të cilëve vetëvrasje. Në të trija këto raste, problematikë mbetet mungesa e monitorimit periodik të gjendjes shëndetësore nga ana e stafit mjekësor, dhe ndjekjes së menjëhershme të shqetësimeve të shfaqura nga të burgosurit.

Një ngjarje e rëndë dhe e paprecedentë u shënuar në sistemin tonë të burgjeve në dt.15 Dhjetor 2023, në IEVP Peqin, ku humbi jetën shtetasi A.LL. Hetimi i prokurorisë do të shërbejë për zbardhjen e ngjarjes. Vlen të theksohet se, ankesat e përcjella ndër vite pranë KShH-së nga të dënuarit e frikësuar nga hakmarrja dhe gjakmarrja, edhe pse sporadike në numër, kanë qenë të vazhdueshme në sistemin e burgjeve. Ato duhet të ishin këmbanë e mjaftueshme alarmi për marrjen masave parandaluese për të siguruar jetën e çdo të dënuari dhe paraburgosuri.

Për shkak të angazhimit prej vitesh në sistemin e burgjeve, numri më i madh i ankesave që vijnë në KShH i përkasin shtetasve të dënuar dhe paraburgosur. Nga një total prej 584 ankesash të marra përgjatë dy viteve, 50% e tyre i përkasin këtyre shtetasve, të cilët ankohen më së shumti për sistemin e drejtësisë, si dhe për kushtet e të drejtat e tyre në sistemin e burgjeve, transferimet pranë familjarëve, lejet shpërblyese, masat e padrejta disiplinore, etj. KShH ka përcjellë në mënyrë të rregullt ankesat e marra dhe problematikat e konstatuara në Institucionet e Sistemit Penitenciar, por në shumë raste nuk

kemi patur një përgjigje për qasjen e institucioneve ndaj trajtimit dhe verifikimit të tyre dhe nivelin e reflektimit².

Në vijim të monitorimeve të realizuara për situatën e respektimit të të drejtave të personave të ndaluar apo shoqëruar në komisarate, janë konstatuar problematika të natyrës infrastrukturore, mungesë të ajrimit dhe dritës natyrale të mjaftueshme, mbipopullim në rast të shoqërimit të protestuesve.³ Vijon të jetë një shqetësim sistemik mosrespektimi i afateve dhe rregullave proceduriale, mungesa e kontrollit fillestar dhe periodik nga mjeku si dhe mos dokumentimi i duhur i gjendjes shëndetësore të shtetasve në kartelat mjekësore. Vonesa në transportimin urgjent drejt ambienteve spitalore civile, të shtetasit të arrestuar L.K., rezultoi fatale për jetën e tij. Por pavarësisht nga shkeljet e konstatuara në reagimin publik të KShH-së, pas më shumë se një viti nga kjo ngjarje, Prokuroria e Tiranës i kërkoi gjykatës pushimin e çështjes. Në raport me korrespondencën zyrtare me strukturat e policisë së shtetit, është pozitive qasja reaguese nga DPPSh, mbi gatishmërinë në marrjen e masave organizative për ndjekjen e rekomandimeve/sugjerimeve të adresuara nga KShH.

Në prill 2022, KShH reagoi publikisht duke shprehur keqardhje mbi përjashtimin e paargumentuar dhe në mënyrë jotransparente të përfaqësuesit/es të KShH-së nga Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët. Ministri i Brendshëm i asaj kohe, bëri të ditur se KShH dhe organizatat e shoqërisë civile mund të marrin pjesë në rolin e vëzhguesit në mbledhjet e Komisionit, por deri më sot ky zotim nuk është respektuar.

Në vitin 2023, rruga e migracionit të parregullt në Ballkanin Perëndimor ka pasur disa ndryshime, duke përfshirë rënien e flukseve migratore dhe rritjen e përdorimit të rrugës së Mesdheut Qendror nga migrantët e parregullt dhe kontrabandistët Shqiptarë. Këta të fundit referuar praktikës gjyqësore të studiuar nga KShH rezultojnë se janë të përfshirë në disa operacione të ndihmës së kalimit të paligjshëm të kufirit kundrejt pagesave që variojnë nga 5000 deri në 8000 euro.

Protokolli i nënshkruar mes dy krerëve të Ekzekutivit të Shqipërisë dhe Italisë, për përdorimin e territorit shqiptar për krijimin e zonave të destinuara për pritjen dhe mbajtjen e refugjatëve azilkërkues, në vlerësimin e KShH dhe disa organizatave të shoqërisë civile përbën shqetësim serioz për mungesën e transparencës, konsultimit dhe shkeljen e Konventës së Gjenevës ndaj këtyre shtetasve që migrojnë drejt Italisë dhe kanë si vend origjine shtetet Afrikane.

Për rastin e trajtimit të shtetasve të diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor në Spitalin Psikiatrik Civil ‘Ali Mihali’ Vlorë,⁴ ku u raportuan dhëna shqetësuese nga media investigative,⁵

² Vlen të theksohet praktika pozitive e reagimit të IEVP 325 “Ali Demi” e cila i është përgjigjur në mënyrë të arsyetuar, rekomandimeve të KShH-së, si dhe IM Kavajë dhe IEVP Elbasan, që hartuan plane konkret masash për përmbushjen e atyre sugjerimeve të pranuar prej tyre.

³ DVP Tiranë, Komisarati Nr. 3 (Rruga Mine Peza) dhe Komisarati Nr. 5 (Kamëz).

⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=Vëëbq4FëP0g>

<https://www.youtube.com/watch?v=9isF03KkD0E>

⁵ <https://www.youtube.com/watch?v=Vëëbq4FëP0g>

<https://www.youtube.com/watch?v=9isF03KkD0E>

KShH iu drejtua zyrtarisht Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale⁶ me kërkesë për lejimin e verifikimit në vend të situatës. Nga ky institucion nuk ka patur asnjë përgjigje zyrtare.

Formalitetet dhe vonesat që krijohen nga disa institucione, duke pamundësuar aksesin e KShH-së për të vëzhguar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, dëmtojnë transparencën, llogaridhënien dhe mundësinë për të reflektuar mbi krikat dhe rekomandimet që mund të jenë ndihmuese për to. Këto qasje të mbyllura janë regres për demokracinë, cenojnë lirinë e organizimit dhe vështirësojnë përmbushjen e misionit të KShH-së si një organizatë monitoruese.

Në tërësi vihet re një qasje e mbyllur e institucioneve ndaj raporteve të monitorimit të OSHC-ve si dhe një klimë paragjyquese dhe penguese ndaj organizatave për ushtrimin e misionit të tyre për sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Përkundrajt tendencës tkurrëse me të cilën po përballet sektori i shoqërisë civile në rajon, është pozitiv fakti se organizatat vendase, ato rajonale dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile po bashkëpunojnë për të adresuar format e dhura të reagimit kundrejt lirisë së organizimit dhe të drejtave dhe lirive të njeriut.

Përdorimi i gjuhës së urrejtjes vijon të jetë shqetësues sidomos në një institucion të rëndësishëm që ushtron pushtetin legjislativ (sikurse është Kuvendi) e njëkohësisht në hapësirën digjitale dhe në mediat sociale. Kryesisht forma të ndryshme të gjuhës së urrejtjes motivohen më së shumti nga orientimi seksual, përkatësia fetare, përkatësia etnike dhe bindjet politike.

Sa i takon lirisë së shprehjes dhe sigurisë së medias dhe gazetarëve, është shqetësues fakti se afro një në dy gazetarë, raportuan në 2022 se ndihen të censuruar nga struktura hierarkike dhe drejtuese e redaksisë dhe po kaq prej tyre kanë pësuar vetë-censurë. Ndërkohë, pjesa më e madhe e të anketuarve apo 68% e tyre perceptojnë se media në Shqipëri është pak ose aspak e lirë.

E drejta e informimit ndodhet në një udhëkryq, si rrjedhojë e mosrespektimit nga disa institucione të detyrimeve të ligjit “Për të drejtën e informimit”. Nga praktika e kërkimit të informacionit të KShH-së, viti 2023 shënon një regres të mëtejshëm në raport me 2022, pasi vihet re që institucionet përgjigjen me vonesë ose pjesërisht ndaj objektit të kërkesës. Në disa nga rastet e vendimeve pozitive të Komisionerit ato ankimohen nga institucionet në gjykatë. Por vonesat në gjykim dëmtojnë pa kthim të drejtën e informimit dhe aktualitetin e informacionit të kërkuar.

KShH me anë të stafit avokator ka përfaqësuar një sërë çështjesh të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, me fokus mjedisin, të drejtën e informimit, të drejtat e gazetarëve, të drejtat e personave të privuar nga liria, barazinë dhe mbrojtjen nga diskriminimi, veçanërisht të Komunitetit Rom dhe LGBTIQ+, etj. Në këtë drejtim, janë shënuar disa vendimmarrje pozitive të cilat kanë promovuar standardet më të mira në sistemin e brendshëm gjyqësor, krahas zgjidhjes së problematikës konkrete.

KShH vëren me shqetësim vonesat në ekzekutimin apo mosekzekutim të plotë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, jo vetëm të gjykatave vendase por edhe ato të GJEDNJ-së. Si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimmarrjeve gjyqësore me impakt për interesin publik, si mbi ndotjen mjedisore në Lumin Tërkuzë në Kamëz e në Lumin Gjanicë në Fier, të drejtat mjedisore nuk kanë

⁶ Shkresë nr 617 prot., dt. 20 shtator 2023, “Kërkesë për leje hyrëse në Spitalin Psikiatrik ‘Ali Mihali’ Vlorë”

vëmendjen e duhur të autoriteteve mbikqyrëse që janë detyruar nga gjykatat të zbatojnë kompetencat e tyre, por përpos ligjit as këto vendime nuk po i respektojnë.

Pavarësisht se ankimi në një proces gjyqësor është një e drejtë themelore procedurale e palëve në proces, në çështjet e përfaqësuara nga KShH shpesh përdoret si mjet nga institucionet publike, me qëllim për të vonuar apo pamundësuar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. KShH mbërrin në këtë konkluzion sepse institucionet apelojnë vendimet edhe për kërkime bazike të lidhura me detyrat e tyre funksionale dhe organike, sikurse janë çështjet e lidhura me mungesën e hetimeve të plota e të gjithëanshme nga prokuroria, të drejtat mjedisore apo ato në fushën e mosdiskriminimit.

1 Angazhimi qytetar dhe i shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse dhe ligjvënëse⁷

Përgjatë vitit 2022, KShH realizoi 18 ditë diskutimi të hapura me pjesëmarrjen e nxënësve të Shkollave të Mesme të vendit, si dhe disa prej deputetëve të mandatuar të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. 7 peticione dhe 1 nismë ligjvënëse e ideuar nga të rinjtë, por kjo e fundit e mbështetur nga ana e një deputeteje, u depozituan në Kuvend. Kauzat sociale që të rinjtë adresonin ishin nga më të ndryshmet, si lidhur me të drejtën mjedisore, atë të përfaqësimit demokratik të komuniteteve të marginalizuara, përcaktimin e buxhetit të dedikuar për rininë nga Bashkitë ose fuqizimin e sistemit të karrierës pasuniversitare, si formalizimin e fenomenit të vullnetarizmit. KShH ka kontribuar teknikisht dhe ligjërisht në hartimin e projektligjeve të depozituara në Kuvend nga grupe informale të qytetarëve, si Sindikata e Fermerëve të Bashkuar të Shqipërisë mbi ndryshimet e propozuara në ligjin për TVSH-në dhe atij për bujqësinë e zhvillimin rural, Organizata Politike lidhur me përcaktimin me ligj të posaçëm të minimumit jetik, ose depozitimin e peticionit në favor të garantimit të procesit të inseminimit artificial in-vitro të garantuar nga shteti.

Pavarësisht këtyre përpjekjeve serioze të të rinjve dhe qytetarëve pjesë e grupeve informale, konstatohet mungesë e reagimit sistematik nga Kuvendi, për t'i dhënë përgjigje kauzave të adresuara me anë të peticioneve dhe nismave legjislativë përkatëse. Këto mangësi dobësojnë potencialin për një sistem qeverisjeje më gjithëpërfshirës dhe përfaqësues, si dhe cenojnë besimin e qytetarëve në instrumentat demokratik të pjesëmarrjes në procese vendimmarrëse të Kuvendit.

Bazuar në një studim të mëhershëm⁸, KShH përcolli pranë Kuvendit të Shqipërisë rekomandime që synojnë përmirësimin e procedurave për trajtimin e Peticioneve duke u bazuar në praktikën e ndjekur nga ana e Komisioneve përgjegjëse parlamentare. Megjithatë, pavarësisht nga reagimet pozitive për të reflektuar në raport me rekomandimet e përcjella, rregullorja e Kuvendit ende nuk ka pësuar përmirësime, ndërkohë që Komisionet Parlamentare vijojnë të mos përgjigjen për peticionet dhe oponencat ligjore që KShH ka përcjellë gjatë periudhës 2022 - 2023, sa i takon plotësimin të Kodit Penal pas vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese për dispozitën penale të lidhur me tubimet e paligjshme, rishikimit të rregullores së Kuvendit për të përmirësuar dispozitat mbi peticionet, mbikqyrjes parlamentare ndaj veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesave të qytetarëve si rrjedhojë e parashkrimit të afateve. Nga ana tjetër, pozitiv në faqen e re të Kuvendit është rubrika e platformës së konsultimit, e cila mund të përdoret më mirë nga aktorë të

⁷ Qëndrimet publike të mbajtura nga KShH:

- Peticion ndaj Kuvendit: Të ofrohet riprodhimi i asistuar "In Vitro" edhe në spitalet shtetërore

<https://tirananews.al/organizatat-e-shoqerise-civile-peticion-ndaj-kuvendit-te-ofrohet-riprodhimi-i-asistuar-in-vitro-edhe-ne-spitalet-shtetore/>

- Dokument politikash, sfidat e edukimit ligjor në Shqipëri

https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/01/Dokument-politikash-Sfidat-e-Edukimit-Ligjor-te-Publikut-ne-Shqiperi.pdf?fbclid=IëAR17mpj4FvOL19eJxCxz2XvDBDeAkkO18K8xBqtkbC51_VvKCTGNdCr0J7o

⁸ Raporti studimor i realizuar nga KShH për një periudhë afro 5 vjeçare, janar 2016 - tetor 2020, i aksesueshëm në këtë link:

<https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Raport-Studimor-Instrumentet-ligjore-dhe-sfidat-e-angazhimit-te-qytetareve-dhe-te-shoqerise-civile-ne-proceset-vendimmarrese-dhe-legjislativ-te-kuvendit.pdf>

shoqërisë civile për të adresuar drejtpërsëdrejti komente dhe sugjerime që i shërbejnë përmirësimit të projektligjeve, dhe është e aksesueshme për qytetarët e deputetët.

Pavarësisht nga qëndrimi i shprehur në takime të ndryshme midis organizatave të shoqërisë civile dhe kryetarëve të Komisioneve Parlamentare, KShH vëren se përgjatë viteve 2022 - 2023 ka patur një rënie të ndjeshme të kërkesave të këtyre Komisioneve drejtuar KShH-së, veçanërisht të Komisionit të Ligjeve që mbulon çështjet e të drejtave të njeriut, për konsultimin e projektligjeve si dhe mungesë të konsultimit të raporteve të institucioneve të pavarura. KShH me nismën e saj ka dërguar komente dhe sugjerime për projektligje të ndryshme që trajtojnë çështje që janë të ndërlidhura me misionin e saj, por nuk ka marrë në asnjë rast përgjigje institucionale lidhur me to dhe rrjedhimisht as për nivelin e reflektimit të komenteve dhe sugjerimeve tona⁹.

Në kundërshtim me parimin e barazisë para ligjit, KShH ka vërejtur se Parlamenti i jep prioritet radhës së shqyrtimit të nismave ligjvënëse të ndërmarra nga Ekzekutivi në Programet e Punimeve të tij, duke krijuar një praktikë disavantazhuese për nismat ligjore të deputetëve dhe ato të zgjedhësve. Kjo praktikë nuk është pozitive për demokracinë dhe pjesëmarrjen. Iniciativa të rëndësishme si projektligji i hartuar, depozituar nga ekspertë të shoqërisë civile ‘Për paditë kolektive’ dhe që është mbështetur me nismë deputeti prej më shumë se dy vitesh vijojnë të presin radhën e shqyrtimit në Kuvend¹⁰.

Sa i takon konsultimeve të Ekzekutivit, ato kanë natyrë selektive, ndërkohë që KShH ka konstatuar problematika në drejtim të funksionimit të platformës kombëtare të konsultimit publik të projekt-akteve¹¹.

2 Ndikimi i korrupsionit tek të drejtat dhe liritë e njeriut dhe demokracia në tërësi

Korrupsioni, përveç se dënohet penalisht, dobëson shtetin e së drejtës, dobëson besimin e shtetasve tek institucionet si dhe krijon padrejtësi dhe pabarazi midis shtetasve.

KShH përshëndet vendimmarrjet kurajoze të SPAK dhe GJKKO, me synim ndëshkimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit deri në nivelet e larta të zyrtarëve publike.¹² Kjo veprimtari ka shënuar

⁹ Nisma të tilla si projektligji për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit, mbi amendimet e propozuara në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale, propozimet për rishikimin e dënimeve administrative me gjobë fikse të cilat vijojnë të jenë prezentë në disa prej akteve ligjore në fuqi, etj.

¹⁰ <https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/80cfda5e-a3c6-497e-9def-0cdf23d76ecd>

¹¹ KShH ka hasur vështirësi në adresimin e komenteve/sugjerimeve për ‘Strategjinë Kombëtare të Migracionit 2024-2030’ për shkak të mungesës së parashikimit të seksionit të posaçëm për komente në platformë, si dhe të Programit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian 2030 dhe Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026 për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Funksionimin e Institucioneve Demokratike.

¹² Vlen të theksohet se janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim: 8 procedime penale me 8 të pandehur (ish-Gjyqtar); 3 procedime penale me 3 të pandehur (ish-Prokuror); 1 procedim penal me 2 të pandehur (ish-Deputet); 1 procedim penal me 1 të pandehur (ish-zv.Ministër); 1 procedim penal me 1 të pandehur (anëtare KPK); 4 procedime penale me 4 të pandehur (ish-Kryetar Bashkie).

një rritje progresive përgjatë viteve 2022 dhe 2023, duke përfshirë edhe hetimin dhe dënimin e ish zyrtarëve të nivelit të lartë¹³.

Raportet dhe të dhënat e publikuara, të cilat reflektojnë një numër të shtuar të denoncimeve tregojnë rritje të besimit të qytetarëve ndaj SPAK-ut. E megjithëkëtë këto të dhëna janë tregues indirekt i një besim më të ulët të publikut në prokuroritë e juridiksionit. Ndërkohë është i nevojshëm sensibilizimi i shtuar dhe sistematik i publikut kundrejt kompetencave të SPAK, me synim reduktimin e rasteve të transferimit të çështjeve për mungesë kompetence. Nevojitet sensibilizim i mëtejshëm i qytetarëve pasi intensifikimi i luftës kundër korrupsionit është domosdoshmëri.

Në kuadër të monitorimit nga KShH të veprimtarisë dhe aktivitetit të SPAK, është pozitiv fakti se SPAK ka luajtur një rol proaktiv në ushtrimin e të drejtës së procedimit penal me nismën e tij (*ex officio*) me një rritje rreth 56% në vitin 2022, në raport me vitin 2021. Në harkun kohor 2020-2022, Prokuroria e Posaçme ka arritur të regjistrojë hetime për ish-zyrtarë të lartë, gjithsej 24 procedime penale me 25 persona në hetim.¹⁴ Vlen të përmenden rastet e bëra publike në media si procedimet penale të SPAK dhe dënimi penal i Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë për tenderat e rikonstruksionit të qendrave shëndetësore në Tiranë e Durrës, hetimi i SPAK ndaj ish Ministrit dhe zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë për koncesionin e sterilizimit, vendimmarrjet e GJKKO në Shtator të këtij viti për dënimet për shpërdorim detyre dhe korrupsion për Inceneratorët e Fierit e të Elbasanit, ku ndër të tjerash u dënua për herë të parë për vepra penale në fushën e korrupsionit edhe ish-Ministri i Mjedisit.¹⁵¹⁶

Pas kërkesës së trashëgimtarëve të njërit prej viktimave të mitur në ngjarjen tragjike të Gërdecit, SPAK vendosi revokimin e vendimit të pushimit ndaj ish-Ministrit të Mbrojtjes.¹⁷

Hetime ka patur edhe ndaj kryetarëve apo funksionarëve të tjerë të lartë të Bashkive Durrës, Kukës, Dibër, për veprat penale të lidhura me shpërdorimin e detyrës, shkeljen e barazisë në tendera,

¹³ Gjatë vitit 2020, rezulton se janë trajtuar 238 raste, nga të cilat 50 procedime janë përcjellë për gjykim; 22 procedime janë pushuar; 4 prej tyre janë pezulluar; 28 janë pezulluar dhe 134 raste janë ende nën hetim.

Sa i përket të dhënave të vitit 2021, konstatohet një numër total në rritje i rasteve, përkatësisht 339 raste (ose 101 raste më shumë), nga 33 prej të cilave janë dërguar në gjyq; për 24 raste Prokuroria ka vendosur pushimin e procedimit penal; 9 raste janë pezulluar; 38 raste janë transferuar pranë organeve kompetente, ndërsa 235 raste janë nën hetim.

Sakaq, në vitin 2022, nga 422 raste të shqyrtuara nga Prokuroria e Posaçme, 43 çështje janë përcjellë për gjykim; 30 procedime penale janë pushuar, ndërkohë që 5 raste janë pezulluar; 59 raste janë transferuar pranë organeve kompetente; ndërsa 285 janë nën hetim. Të dhënat për vitin 2023 bëhen publike në vitin 2024, por nga informacioni publik vihet re një numër sistematik rastesh që përfshijnë dhe ish zyrtarë të nivelit të lartë.

¹⁴ https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/raporti-vjetor-2022_Publikuar.pdf fq 4

¹⁵ Njoftim për shtyp (Datë 09.12.2023) - spak.gov.al

¹⁶ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-18-11-2023/>

¹⁷ <https://spak.gov.al/njoftim-27/>

korrupsion pasiv.¹⁸¹⁹²⁰21 Transparenca që SPAK realizon në faqen zyrtare të tij lidhur me këto çështje vlerësojmë se kontribuon pozitivisht në drejtim të informimit të publikut.

Nën hetimin e SPAK kanë qenë edhe zyrtarë publikë pranë Agjencisë së Trajtimin të Pronave²², IKMT-së,²³ Policisë Gjyqësore,²⁴ Avokaturës së Shtetit,²⁵ Bashkisë Tiranë,²⁶ Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore,²⁷ të akuzuar për vepra penale në fushën e korrupsionit. Çështje me vëmendje të lartë publike është edhe ajo për privatizimin e objekteve sportive ‘Partizani’.²⁸ Në 18 dhjetor 2023, Këshilli i Mandateve dhe Rregullores, në Kuvendin e Shqipërisë, miratoi kërkesën e SPAK për arrestimin e ish-kryeministrit, i cili është nën hetim për procedurat e privatizimit, nën dyshimin se ka favorizuar dhëndrin e tij²⁹.

Ndërkohë vlerësojmë se trajtimi i fenomenit të korrupsionit kërkon një qasje të shumëanshme dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë realizimin e reformave të mëtejshme ligjore, forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e transparencës dhe parashikimet e domosdoshme buxhetore ndaj institucioneve e aktorëve përgjegjës.

Edhe gjatë vitit 2023, KShH ka vijuar praktikën e krijimit të urave të bashkëpunimit me institucione publike, të identifikuara nga Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë, me një risk të lartë korrupsioni. Kuadri ynë ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve që denoncojnë korrupsionin në vendin e punës, edhe pse është në vitin e 7 të zbatimit të tij, shënon një impakt të munguar. Sinjalizuesit vijnë të konsiderohen “spiunë” nga vetë kolegët e tyre, numri i sinjalizimeve për korrupsion në vendin e punës mbetet tepër i ulët dhe ato pak raste të sinjalizuara nuk kanë shënuar asnjë sukses në luftën kundër korrupsionit dhe ndëshkimit të tij. Legjislacioni ynë vlen të rishikohet për t’u pajtuar në nivel më të mirë me direktivën e BE-së, që garanton mbrojtje për sinjalizuesit anonim që denoncojnë edhe në kanalet e jashtme apo publikisht.

3 Reforma në Drejtësi

Shqipëria ka hyrë në vitin e 7 të zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë, ndërkohë që KShH në përputhje me misionin e tij ka vijuar të monitorojë disa prej institucioneve të reja të sistemit të

¹⁸ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-07-12-2023-dergim-ceshtje-per-gjykim/>

¹⁹ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-07-12-2023-dergim-ceshtje-per-gjykim/>

²⁰ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-06-12-2023/>

²¹ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-16-09-2023-dergim-per-gjykim/>

²² <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-22-11-2023/>

²³ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-27-10-2023/>

²⁴ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-20-10-2023-dergim-per-gjykim/>

²⁵ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-26-07-2023-dergim-per-gjykim-a-laho/>

²⁶ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-26-07-2023-bashkia-tirane/>

²⁷ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-25-07-2023-akbpm/>

²⁸ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-22-10-2023/>

²⁹ <https://ëëë.balkanëeb.com/voa-keshilli-i-mandateve-miraton-kerkesen-e-spak-per-arrestimin-e-berishes/#gsc.tab=0>

drejtësisë (institucionet e vettingut dhe ato të qeverisjes së drejtësisë), si dhe zhvillime të tjera të rëndësishme sikurse është ri-organizimi gjyqësor i vitit 2022³⁰.

3.1 Eficiencia gjyqësore dhe sfidat e organeve të qeverisjes së drejtësisë

Gjatë vitit 2023, KShH i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave për ri-organizimin gjyqësor, duke argumentuar cenime të parimeve dhe të drejtave kushtetuese si aksesit në drejtësi, gjykata e krijuar me ligj, si dhe parimi i proporcionalitetit. Si rrjedhojë e efekteve të Hartës së Re Gjyqësore, 18 gjykata rezultojnë të shkruara ose 47.3 % e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit që vendi ynë kishte para këtij riorganizimi gjyqësor, duke sjellë një zhvillim të paprecedentë në raport me hartat gjyqësore të vendeve në rajon dhe vendeve anëtare të vetë BE-së.

Të dhënat që KShH ka siguruar me anë të korrespondentëve e pikave të tij të kontaktit në Gjirokastrë, Vlorë, Korçë dhe Shkodër³¹, nxjerrin në pah rritje të kostove të shërbimit avokator, në masën që varion nga 50%-200% të tarifave të mëparshme, si dhe kosto tepër të larta transporti për ndjekjen e seancave gjyqësore nga Avokatët e çështjeve të transferuara pranë gjykatave të reja. Gjithashtu, përdoruesit e gjykatave ankohen edhe për kohën që i dedikojnë proceseve që çojnë deri në humbjen e ditëve të punës, si dhe vonesat në gjykimin e këtyre çështjeve, duke treguar shkurajim për të iniciuar procese të reja gjyqësore, veçanërisht në Gjykatën e vetme të Apelit. Këto të dhëna flasin në fakt për një përkeqësim të aksesit të qytetarëve në drejtësi.

Nëse do të krahasojmë të dhënat për eficiencën gjatë vitit 2022 në raport me ato të vitit 2023, që shënon edhe fillimin e efekteve të zbatimit të hartës së re gjyqësore, vihet re ulje e mëtejshme e eficiencës së gjykatave të reja edhe pse propozimi për shkrirjen e gjykatave synoi të kundërtën. Bazuar në të dhënat që KShH disponon, për periudhën shkurt – shtator 2023, vihet re se Gjykata e vetme e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka evaduar 1712 çështje më pak krahasuar të njëjtën periudhë të një viti më parë, nga 6 gjykatat e apelit tashmë të suprimuara. Rënie e efikasitetit gjyqësor vërehet edhe në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, të cilat pas bashkimit kanë gjykuar 4260 çështje më pak ose rreth 85% të numrit të çështjeve të të njëjtës periudhës para bashkimit. Gjithashtu, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë kanë gjykuar vetëm 75% të çështjeve, ose 451 çështje më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë të mëparshme korrik-shtator 2022.

Përkundrejt rekomandimeve të KE-së, KShH vëren se edhe gjatë 6 muajve të parë të vitit 2023, KLP ka vijuar të mos presë vendimmarrjet e organeve të vettingut, me qëllim ngritjen në detyrë të magistratëve (prokurorë) duke i dhënë në këtë mënyrë prioritet të drejtës për karrierë të subjektit konkurrues.

³⁰ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/07/21/495/47876633-7e33-4294-9c85-00fc1be32e90;q=Vendimit%20t%C3%AB%20K%C3%ABshillit%20t%C3%AB%20Ministrave%20nr.495,%20dt.21.07.2022%20E2%80%9CP%C3%ABr%20riorganizimin%20e%20rretheve%20gjyq%C3%ABsore%20dhe%20kompetencave%20t%C3%ABsore%20t%C3%AB%20gjykatave>

³¹ Qytete që përbëjnë qendrat e qarqeve ku më parë ishin vendosur gjykatat e Apelit dhe gjykatat administrative të shkallës së parë.

Në funksion të besimit të publikut, përgjegjësia për të provuar të kundërtën për çdo dyshim me peshë publike për korporatizëm dhe klientelizëm në procesin e emërimeve dhe promovimeve në sistemin e drejtësisë i takon vetëm Këshillave. Një nga këto raste është edhe debati publik i krijuar si rrjedhojë e emërimeve/transferimeve të realizuara nga KLP për 3 prokurorë dhe 1 oficer të policisë gjyqësore me lidhje familjare në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë dhe lidhjet e tyre me funksionarë të Kuvendit³². Pavarësisht justifikimit nga KLP të vendimeve si rrjedhojë e mungesës së ndalimeve të papajtuësishme ambientale në rastet në fjalë, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese³³, në një vend të vogël si Shqipëria, kjo situatë nuk ndihmon në forcimin e besimit publik tek veprimtaria e Këshillave. Situata nuk trajtohet prej Këshillit në një sfond bardh e zi, pasi nuk duhet të harrojmë edhe për shumë vite deri në konsolidimin e sistemit, shkaqet që detyruan vendin të reformonte sistemin e drejtësisë duke përfshirë këtu ndikimet e papërshtatshme në sistem.

Organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë kërkojnë një monitorim sistematik dhe të jashtëm, me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi, transparencja dhe përgjegjshmëria e këtyre institucioneve, e të parandalohen ndërhyrjet e papërshtatshme në veprimtarinë e Këshillave. Në këtë drejtim, integriteti profesional dhe etik i anëtarëve të Këshillave ka nevojë të fuqizohet.

Në raportin e fundit, KE evidenton se Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar një metodologji të rishikuar për të reduktuar numrin e 1606 ankesave për shkelje disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të trashëguara nga institucionet e mëparshme. Lidhur me këto të dhëna, KShH dëshiron të ndajë shqetësimin e ngritur pranë Kuvendit të RSH për ushtrim të mbikqyrjes parlamentare, pasi vonesat domino në ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë, të cilat ndikuan në vonesat e shqyrtimit të ankesave ndaj shkeljeve të magjistratëve, nuk duhet të përbëjnë shkak për mostrajtimin dhe hetimin e tyre, me pasojë arkivimin nga ILD (ankesa të depozituara para reformës në drejtësi).

3.2 Eficiencia dhe standardet e vendimmarrjes së institucioneve të vettingut

Monitorimet e realizuara nga ekspertët e KShH-së nxjerrin në pah se institucionet vendimmarrëse të vettingut³⁴, gjatë periudhës që mbulon ky raport kanë bërë përpjekje të mëtëjshme për përshpejtimin e procesit të vettingut dhe respektimin e të drejtës së procesit të rregullt kundrejt subjekteve të rivlerësimit.

Edhe pse po përmbillet viti i 6 i procesi i vendimmarrjeve të para të vettingut, KShH vëren se në raport me numrin e lartë të vendimmarrjeve të shkarkimit dhe të pushimit të procesit si rrjedhojë e dorëheqjes, rastet kur ka filluar hetimi i prokurorisë janë të pakta³⁵. Një pjesë e këtyre procedimeve i kanë kaluar nga SPAK për mungesë kompetence, prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Kjo pasi akuzat e ngritura për subjektet që nuk janë të posaçëm (nuk janë anëtarë të Gjykatës së Lartë, Kushtetuese apo Prokurori i Përgjithshëm), nuk lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit, por me mosdeklarimin apo fshehjen e të ardhurave. Rrjedhimisht rezultatet e procesit të vettingut u shfaqën më së shumti në sferën administrative dhe ato nuk i shërbyen mjaftueshëm organit të

³² <https://euronews.al/motra-e-ermonela-felaj-emerohet-prokurore-ne-tirane/>

³³ Vendimi i GJK të vitit 2017 dhe ligjit të rishikuar më pas nr.96/2016.

³⁴ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Komisioni i Posaçëm i Apelimit (KPA)

³⁵ Ndërkohë janë dhënë edhe vendime gjyqësore të dënimit penal, sikurse është ai i Ish Prokurorit të Përgjithshëm.

prokurorisë për të hetuar në drejtim të vendosjes efektive para përgjegjësisë penale të subjekteve të korruptuar dhe me pasuri ndjeshëm të pajustificueshme.

Si rrjedhojë e vonesave që pati mbarëvajtja e procesit të vettingut sipas parashikimeve fillestare të ndryshimeve kushtetuese të Korrikut të vitit 2016, në vitin 2022 Kushtetuta ndryshoi sërish.³⁶ Nisur nga të dhënat e bëra publike nga vetë KPK, evidentohet se në periudhën shkurt 2022-nëntor 2023, janë dhënë rreth 205 vendime, prej të cilave afro më shumë se gjysma (56%) janë vendime konfirmimi në detyrë.³⁷ Ndërkohë sipas të dhënave të KPA-së, nga viti 2018 deri në nëntor 2023, janë dhënë 219 vendime, prej të cilave në shumicën e rasteve (76% të vendimeve) është lënë në fuqi vendimi i KPK-së. Njëjtë si në vitet e mëparshme, pasuria mbetet kriteri më i ndjeshëm dhe me ndikimin më të madh në vendimmarrjet e shkarkimit të KPK-së.

Me shqetësim, KShH vëren se periudha e hetimit administrativ nga momenti i shortimit, zgjat mesatarisht 2 vjet dhe pothuaj po kaq zgjat procesi i shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit të KPK (nëse ka). Në total i gjithë procesi i rivlerësimit zgjat rreth 4 vjet (për subjektet ndaj të cilëve paraqitet ankim ose që paraqesin ankim ndaj vendimit të KPK). Kjo periudhë jo proporcionale, ka një efekt të lartë financiar evident në rastet e gjyqtarëve të shkarkuar. Këta të fundit deri sa vendimi të marrë formë të prerë, pra pas vendimmarrjes në KPA (kur është paraqitur ankim) trajtohen financiarisht në masën 75% të pagës. Për KPK-në është prioritet përfundimi i procesit brenda afatit të ri kushtetues pasi disponon vetëm një vit deri në përbushje të këtij afati.

Sa i takon aspekteve të transparencës, në tërësi ajo vlerësohet pozitive. Ndërkohë evidentohet si nevojë, argumentimi i përmbledhur i vendimmarrjeve të ndërmjetme në seancën gjyqësore, publikimit në kohë reale i seancave të planifikuara nga KPK, pasqyrimi në faqe zyrtare të datës së publikimit të vendimmarrjes, pasqyrim dhe argumentim më i mirë i objektit dhe bazueshmërisë së denoncimeve të publikut në vendimmarrjet e institucioneve. KShH rithekson në mënyrë të përsëritur nevojën për unifikimin e analizës financiare të kriterit të pasurisë, kundrejt detajimit të plotë e sa më të qartë të elementëve përbërës të analizës financiare.

4 E drejta për të zgjedhur e për t'u zgjedhur gjatë dy proceseve zgjedhore 2022-2023

³⁶ Ndryshimet kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 16/2022, datë 10.2.2022 bënë të mundur shtyrjen e mandatit të KPK dhe Komisionerëve Publikë deri më 31.12.2024. Në favor të kësaj shtyrje, qëndrimi publik i mbajtur nga KShH u vlerësua edhe nga vetë Komisioni i Venecias.

³⁷ Nga 28 shkurti 2022 deri në 27 dhjetor 2022, KPK ka dhënë 97 vendime, nga të cilat:

- 53 vendime konfirmimi në detyrë për 24 gjyqtarë, 28 prokurorë, 1 ndihmës/këshilltar ligjor;
- 26 vendime për shkarkim nga detyra për 11 gjyqtarë, 14 prokurorë;
- 13 vendime për ndërpreje procesi (neni G i Aneksit të Kushtetutës) për 9 gjyqtarë, 1 prokuror, 2 ndihmës ligjorë, 1 ish-prokuror;
- 3 vendime për përfundim procesi pa vendim përfundimtar;
- 2 vendime për pezullim nga detyra.

Nga 27 dhjetori i vitit 2022 deri në 30 nëntor të vitit 2023, KPK ka dhënë 110 vendime, nga të cilat:

- 63 vendime konfirmimi në detyrë për 27 gjyqtarë, 35 prokurorë, 1 inspektor në KLGJ;
- 26 vendime për shkarkim nga detyra për 11 gjyqtarë, 16 prokurorë, 1 ish-gjyqtarë në GJL;
- 11 vendime për ndërpreje procesi (neni G i Aneksit të Kushtetutës) për 4 gjyqtarë, 5 prokurorë, 3 ndihmës ligjorë;
- 10 vendime për përfundimin e procesit pa vendim përfundimtar.

KShH, me anë të vëzhguesve të akredituar të tij, ka monitoruar të dy proceset zgjedhore për organet e qeverisjes vendore, përkatësisht atë të pjesshëm, të zhvilluar më 6 mars 2022, dhe atë në rang kombëtar, të zhvilluar më 14 maj 2023.

Klima në tërësi e proceseve të monitoruara është reflektuar e qetë, me përjashtim të disa incidenteve³⁸. Shkeljet dhe parregullsitë procedurale mbeten të së njëjtës natyrë si në zgjedhjet e kaluara, duke diktuar nevojën e përmirësimit të efektshmërisë së ligjit për dekriminalizimin, demokratizimin e procesit të propozimit të kandidatëve nga subjektet zgjedhore, garantimin e lirisë së mbulimit mediatic dhe adresimit të rekomandimeve të OSBE/ODIHR lidhur me problemin e përdorimit të kasetave të gatshme, rritjen e iniciativës, objektivitetit dhe eficiencës së hetimeve të prokurorive për të garantuar ndëshkueshmërinë e krimeve zgjedhore³⁹. KShH ka përsëritur rekomandimin për marrjen e masave të hershme në kohë dhe në mënyrë të plotë nga ana e Ministrisë së Brendshme dhe organeve të qeverisjes vendore për garantimin e njoftimit me shkrim të zgjedhësve, në përputhje me të dhënat e ekstraktit të tyre zgjedhor.

Edhe pas publikimit të raportit të OSBE/ODIHR, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore vazhdon të mos funksionojë gjë që mund të shoqërohet me vështirësi dhe pengesa për zgjedhjet e vitit 2025, në mënyrë të veçantë për votimin e shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit. Me keqardhje vërejmë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i një viti më parë vijon të mbetet i paekzekutuar sa i takon detyrimin që ka Kuvendi për plotësimin e boshllëkut ligjor që mundëson ushtrim efektiv të së drejtës kushtetuese të votës së emigrantëve.

Anëtarët e administratës zgjedhore lokale⁴⁰ janë gjetur pjesërisht të papërgatitur për të kryer detyrat e tyre, sidomos në rastet kur kanë qenë rishtazi të zëvendësuar përpara zhvillimit të procesit zgjedhor. KShH ka rekomanduar marrjen e masave për depolitizimin total të administratës lokale zgjedhore. Të dy proceset u karakterizuan nga prezenca e personave të paakredituar brenda qendrave të votimit dhe në afërsi të tyre, në kundërshtim me urdhërin e Komisionerit Shtetëror të KQZ-së⁴¹. Shpërdorimi i aseteve publike, votimi familjar dhe procesi i dhënies së ndihmës ndaj zgjedhësve që nuk mund të

³⁸ [https://ahc.org.al/deklarate ngjarja-e-vaut-te-dejes-te-hetohet-me-perparesi/](https://ahc.org.al/deklarate_ngjarja-e-vaut-te-dejes-te-hetohet-me-perparesi/)
<https://www.balkanweb.com/zgjedhjet-ne-durres-shenohet-incidenti-i-pare-goditet-jashte-qv-komisioneri-i-pd/#gsc.tab=0>
<https://lapsi.al/2022/03/06/incident-zgjedhor-ne-diber-shpallet-ne-kerkim-nje-40-vjecar-pasi-rrahu-komisionerin/>
<https://a2news.com/incident-ne-diten-e-zgjedhjeve-goditet-kandidati-i-ps-erion-isai>
<https://shqiptarja.com/lajm/zgjedhjet-e-14-majit-30-incidente-ne-disa-qtete-gjate-votimeve-boci-e-noka-hyne-ne-disa-qendra-te-votimit-ne-elbasan-probleme-edhe-ne-durres-kavaje-diber-kamze-fier-e-korce>

³⁹ Qëndrime të mbajtura nga KShH:

https://ahc.org.al/.../KShH_Sinjalizim_Keqinformim-dhe...
<https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/videos/1312992209612489/>
https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/09/Raporti-Perfundimtar-per-Monitorimin-e-Zgjedhjeve-19-Shtator-2023.pdf?fbclid=IwAR2Y1C0n9SyF4URkX7d_TMIhIe25X90_hu4QeXIPZtXpHz9oH7SA0oLG88
<https://ahc.org.al/subjektet-zgjedhore-te-mos-kufizojne-mbulimin-mediatic-per-zgjedhjet-e-qeverisjes-vendore-te-dt-14-maj-2023-ne-respekt-te-pavaresise-editoriale-te-mediave/>
<https://ahc.org.al/kshh-percjell-sinjalizimin-mbi-keqinformimin-dhe-presionin-e-ushtuar-ndaj-disa-qtetareve-ne-bashkine-elbasan-per-leximin-e-votes-nga-te-tretet-te-ushtuar-me-sistemin-e-pilotimit-te-votimit-d/>

⁴⁰ Nënkupton KZAZ (Komisionet e Zonave Administrative Zgjedhore) dhe KQV (Komisionet e Qendrave të Votimit)

⁴¹ Ndalar nëpërmjet Nenit 109, pika 6 të Kodit Zgjedhor dhe Urdhërit nr. 62, dt. 03.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

votojnë vetë në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor vijojnë të jenë probleme sistemike të procesit që dëmtojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme.

SPAK ka regjistruar procedime penale ndaj disa shtetasve për kryerjen e korrupsionit pasiv ose aktiv në zgjedhje, ose ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike⁴², ndërkohë që mungesa e njohurive të denoncuesve ka bërë që ata t'i drejtohen Prokurorive të Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm, duke pasqyruar vonesa si rrjedhojë e shpalljes së moskompetencës e regjistrimit të procedimeve penale nga SPAK rreth 2 vite me vonesë.⁴³ KShH ka vërejtur standarte të ndryshme në drejtim të masave të sigurisë për raste analoge, siç është ai i Kryetarit të Bashkisë Rrogzhinë⁴⁴ dhe kandidatit të zgjedhur për Kryetar të Bashkisë Himarë⁴⁵, të akuzuar secili për 'Korrupsion aktiv në zgjedhje, në bashkëpunim'.

5 Të drejtat pronësore

Në kuadër të Klinikës Ligjore Falas, KShH ka marrë dhe trajtuar 7 ankesa për vitin 2022 dhe 5 ankesa për vitin 2023, sa i takon shkeljeve të pretenduara nga shtetasit për cënim të së drejtës së pronës, nga autoritetet publike ose subjekte private.

Nisur nga ndjeshmëria publike dhe natyra e shkeljes së pretenduar, KShH ka ndërmarrë gjatë vitit 2022 një mision monitorues për ankesën e banorëve të Njesisë Administrative Bërçull (Bashkia Vorë). Banorët në atë kohë protestuan ndaj mungesës së konsultimit publik efektiv dhe masës së kompensimit financiar në sajë të shpronësimit për interes publik të pasurive të tyre të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i aksit rrugor Thumanë-Kashar. Pas monitorimit në terren në nëntor 2022, KShH evidentoi cënim të parimit të sigurisë juridike. Subjekti privat në momentin e fillimit të punimeve për realizimin e këtij projekti, nuk ka patur as leje zhvillimi dhe as leje ndërtimi, ndërkohë që ndaj banorëve rezultoi se është operuar me zgjidhje ekstra ligjore pasi nuk ka patur një procedurë të mirëfilltë dhe akt shpronësimi nga Këshilli i Ministrave, të komunikuar ndaj tyre. Rekomandimet publike të adresuara nga KShH ndaj një sërë institucionesh⁴⁶, ndër të cilat IKMT dhe IMT Bashkia Vlorë, e strukturave të policisë gjyqësore dhe të prokurorisë, nuk kanë marrë asnjë përgjigje konkrete.

⁴² <https://spak.gov.al/dergim-per-gjykim-korrupsioni-aktiv-dhe-pasiv-ne-zgjedhje/>
<https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-17-08-2023-dergim-per-gjykim/>
<https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-05-12-2023/>
<https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-02-11-2023/>
<https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-20-10-2023-dergim-per-gjykim/>
<https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-09-06-2023-2/>

⁴³ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-13-10-2023-dergohet-per-gjykim-ceshtja-penale-korrupsion-aktiv-dhe-pasiv-ne-zgjedhje/>

⁴⁴ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-02-11-2023/>

⁴⁵ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-01-08-2023-dergim-per-gjykim-dhionisios-alfred-beleri/>

⁴⁶ Monitorimi i të drejtave pronësore të banorëve të Njesisë Administrative Bërçull që preken nga autostrada Thumanë Kashar <https://ahc.org.al/monitorimi-i-te-drejtave-pronesore-te-banoreve-te-njesise-administrative-berxull-qe-preken-nga-autostrada-thumane-kashar/>

Në tjetër rast flagrant i monitoruar nga KShH, përbën rasti i ndotjes mjedisore në Njësinë Administrative Zharrëz⁴⁷, në Bashkinë Patos të Qarkut Fier, shkaktuar nga veprimtaria e kompanive hidrokarbure. Vëzhguesit në terren konstatuan ndotje shqetësuese të pronave private përreth zonës. Duke qënë se shumica e banorëve janë përballur me dëmtimin e banesave si rezultat i lënkundjeve të zonës naftë-nxjerrëse por edhe për faktin e pamundësisë së shfrytëzimit efektiv të pronave të tyre, KShH ka përcjellë raportin e monitorimit së bashku me rekomandimet, pranë institucioneve të cilët janë përgjegjës sipas ligjit, për ndalimin e cënimit dhe kthimin e situatës në gjendjen e mëparshme. Por lidhur me këto rekomandime nuk ka marrë përgjigje.

KShH, në bashkëpunim me Qendrën Res Publica dhe Shoqatën “Për mbrojtjen e pronave dhe mjedisit të pellgut të Drinit të Zi” i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, me kërkesë mbi pajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjit të posaçëm për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Banorët, interesat e të cilëve janë përfaqësuar në këtë proces nga aktorët e shoqërisë civile, pretendojnë se nuk janë konsultuar paraprakisht mbi këtë projekt madhor e me interes publik, ndërkohë që janë cenuar parimet kushtetuese si ai sigurisë juridike, barazisë para ligjit, kriteri i proporcionalitetit, si dhe vlerat themelore, liritë e të drejtat substanciale ekonomike, sociale e kulturore.

6 E drejta për arsim

Referuar të dhënave të bëra publike në media⁴⁸, disa nga problematikat në ushtrimin e të drejtës për t’u arsimuar në vendin tonë përgjatë viteve 2022-2023, janë të mbartura nga vitet e mëparshme, ndërkohë që janë shfaqur edhe problematika të reja. Ndër to janë infrastruktura jo e përshtatshme në disa shkolla publike dhe mungesat e aksesit të përshtatshëm të fëmijëve në disa fshatra që udhëtojnë në kushte të vështira për të marrë arsim të detyrueshëm, rënia e cilësisë së mësimdhënies, mungesa e laboratorëve, rënia e numrit të nxënësve si pasojë e fenomenit të emigrimit, mangësitë në mësim nxënie që krijoi sistemi online i arsimit gjatë pandemisë, miratimi i ligjit tashmë të pezulluar në Nëntor të këtij viti nga Gjykata Kushtetuese, për detyrimet ndaj studentëve të fakultetit të mjekësisë⁴⁹.

Janari i vitit 2022, e përballi Ministrinë e Arsimit me reagimin protestues të Sindikatës së Pavarur të Arsimit Parauniversitar⁵⁰, të cilët kërkuan përmirësimin e kushteve të punës, siguri në punë në raport me Covid-19, rritjen e pagës dhe e pagesave për orët e realizuara mbi normë. Duke patur parasysh rritjen e numrit të infektiveve apo variantet e reja të pandemisë, KShH reagoi për vëmendje të shtuar dhe më shumë transparencë nga ana e Ministrisë së Arsimit mbi efektet e kësaj situatë kundrejt

⁴⁷ https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/11/Njoftim_Konkluzionet-Paraprake-per-Ndotjen-Shqetesuse-ne-Zharrez.pdf

⁴⁸ <https://citizens-channel.com/2023/10/23/pa-rruge-pa-uje-pa-shkolle-fshati-i-harruar-i-beratit/>
<https://abcnews.al/problemet-e-arsimit-pergatitja-e-mesuesve-dhe-infrastruktura-ekspertja-pandemia-i-theksoi/>
<https://www.evropaelire.org/a/bie-numri-nxenesve-shkolla-filllore-mesme/32588056.html>
<https://top-channel.tv/2023/11/14/gjykata-kushtetuese-pezullon-ligjin-per-studentet-e-mjekesise/>

⁴⁹ Ligji nr.60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “mjekësi e përgjithshme” në institucionet e arsimit të lartë”, i cili i detyron studentët të punojnë deri në pesë vjet në Shqipëri në të kundërt duhet të paguajnë shtetin pas diplomimit.

⁵⁰ Protestë e realizuar më 20 Janar 2022

mësuesve dhe nxënësve, masat e marra për motivimin e mësuesve në kushtet e ngarkesës apo zëvendësimit të kolegëve të tyre, si dhe masat parandaluese që i shërbejnë përmirësimit të situatës.⁵¹

Në Shtator 2022, u vendos mbyllja e Kolegjit Turk “Mehmet Akif Ersoy”. Monitorimi i KShH-së evidentoi se vendosja e masës më të ashpër dhe të pamotivuar nga Ministria e Arsimit, ishte e nxituar, joproporcionale dhe me pasoja të dëmshme për vijueshmërinë e arsimit të rreth 159 nxënësve.⁵² Proceset gjyqësore administrative të zhvilluara në kuadër të padisë së institucionit arsimor privat u monitoruan nga vëzhguesit e KShH-së, të cilët raportuan mungesë të hetimit gjyqësor të gjithëanshëm duke u bazuar në interesin më të lartë të fëmijës (referuar Konventës së OKB për të Drejtat e Fëmijës). Gjithashtu u konstatuan elementë të cënimit të parimit të paanshmërisë së gjykatës dhe parimit të kontradiktoritetit, çka nuk i vendosi palët ndërgjyqëse në pozita të barabarta.⁵³

7 Të drejtat e personave të ndodhur në kushtet e privimit të lirisë

Monitorimet në institucionet e mbyllura vijojnë të jenë një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë së KShH-së. Në vitet 2022-2023, KShH ka realizuar 26 misione monitorimi tematik dhe sporadik në institucionet e mbyllura, e më konkretisht 20 prej tyre janë ndërmarrë në ambientet e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP)⁵⁴, 5 në Komisaritet e Policisë⁵⁵ dhe 1 vizitë në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Kareç.

Kryesisht, aksesit për vëzhgimin e institucioneve të monitoruara ka qenë përgjithësisht i mirë. Megjithatë, me keqardhje vërejmë se në 2 raste ky akses është penguar në mënyrë të pajustificuar dhe të pabazuar, në dy IEVP (313⁵⁶ dhe në Rrogozhinë). Në vlerësimin e KShH-së, kjo qasje përbën një regres ndaj veprimtarisë së njohur e të pranuar ndër vite të KShH-së në monitorimin e sistemit të burgjeve dhe nuk i shërben bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet institucioneve të sistemit të burgjeve dhe KShH-së, kundrejt qëllimi të përbashkët për respektimin e të drejtave dhe lirive të të burgosurve dhe paraburgosurve.

8 Të drejtat e njeriut në institucionet penitenciare⁵⁷

Në mënyrë të veçantë gjatë vitit 2023, rastet e monitoruara në sistemin e burgjeve kanë qenë të ndjeshme dhe me pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e të dënuarve. KShH monitoroi humbjen e

⁵¹ <https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/posts/pfbid02xF4QCtChSBDadKURPQuëpaZqhxpcKgL4navhXqMdëYJEoJ6tYoGno397SsCqmQG7l>

⁵² <https://ahc.org.al/deklarate-per-shtyp-5/>

⁵³ <https://ahc.org.al/konkluzione-per-monitorimin-e-procesit-gjyqesor-administrativ-per-sigurimin-e-padise-per-mbylljen-e-kolegjit-mehmet-akif-ersoy/>

⁵⁴ Gjatë vitit 2022 janë realizuar 8 misione monitorimi; Gjatë vitit 2023 janë realizuar 12 misione monitorimi.

⁵⁵ Gjatë vitit 2022 janë realizuar 4 misione monitorimi; Gjatë vitit 2023 është realizuar 1 mision monitorimi.

⁵⁶ <https://ahc.org.al/institucionet-pengojne-vezhguesit-e-kshh-se-te-monitorojne-praktiken-per-humbjen-e-jetes-se-te-pandehurit-e-sheshi/>

⁵⁷ Qëndrime të mbajtura nga KShh:

- Kushtet në burgje dhe paraqitja e situatës

https://top-channel.tv/video/nis-hetimi-per-enver-sheshin-kushtet-ne-burgje-ja-si-paraqitet-situata-breaking-top-neës/?fbclid=IëAR0eQQ7vFG-e_N5GusJKRUQteRnGj_AYpVh-oq4fuNNOZcPb5GNDre6RBnc

- Ngjarje e rëndë në burgun e Drenovës

jetës së shtetasve E.Sh. në ambientet e I EVP 313, si dhe të burgosurit të I EVP Fier S.T. rrugës për në spitalin civil Fier, e vetëvrasja e të burgosurit Q.H në ambientet e I EVP Lezhë. Vëzhguesit e KShH-së u përballën me mungesë të aksesit në informacion në rastin e ngjarjes me viktimë të paraburgosurin E.Sh. Lidhur me këtë ngjarje, KShH evidentoi si problematikë vakancat në radhët e mjekëve, mosmarrjen e masave efektive për ofrimin e ndihmës së nevojshme mjekësore nga stafi infermieror prezent në vendngjarje, si dhe u konstatua korrigjim i të dhënave në regjistrat e administruara nga stafi institucional. Në të trija këto raste, me pasojë vdekjen e shtetasve të privuar nga liria, problematikë mbetet mungesa e monitorimit periodik të gjendjes shëndetësore nga ana e stafit mjekësor, dhe ndjekjes së menjëhershme të shqetësimeve të shfaqura nga të burgosurit, duke krijuar vonesa në trajtimin adekuat e të individualizuar të këtyre shtetasve.

Pavarësisht se është adresuar në mënyrë sistematike, KShH vëren se I EVP-të e monitoruara nuk e kanë finalizuar procesin e miratimit të Rregulloreve të Brendshme, duke krijuar hapësira për zbatimin e rregullave ekstraligjore, në trajtimin e shtetasve të burgosur. Vakancat në stafin mjekësor, atë psiko-social dhe me uniformë, ndryshimet e vazhdueshme në stafin drejtues të institucioneve shpesh pa përvojën e duhur, si dhe nevojat për trajnime të stafit ekzistues mbeten sfida dhe prioritete në sistemin e burgjeve. Paqëndrueshmëri e stafit dhe rekrutim i stafit të ri pa eksperiencë në sistemin penitenciar, është praktikë e vërejtur në I EVP Reç, I EVP Vlorë dhe I EVP Peqin. Pavarësisht masave të marra nga KShH për rritjen e kapaciteteve të stafit psiko-social të Institucionit e të Miturve Kavajë mbi programin ToPs, ngarkesa dinamike e tyre e ka shndërruar në të pazbatueshëm këtë kurrikulë.

8.1 Mbipopullimi

Përgjithësisht, institucionet e monitoruara nuk janë vërejtur në kushte mbipopullimi, duke funksionuar në përputhje me kapacitetet institucionale që disponojnë.

Përfundimisht, vërehet në rastin e I EVP Tepelenë (Bënçë), i cili në muajin gusht 2022⁵⁸, ka akomoduar 100 shtetas, rreth 33% më shumë se kapaciteti funksional akomodues. Pavarësisht kësaj popullate të evidentuar në institucion, për shkak se institucioni është i pajisur me 110 shtretër, secili nga të burgosurit ka qenë i pajisur me shtroje për fjetje individuale. Në Mars të këtij viti, vëzhguesit e KShH-së konstatuan nivele shqetësuese mbipopullimi, në ambientet e dy godinave të I EVP Shënkoll, ku janë akomoduar pacientët me masë mjekësore. Krahas kapacitetit institucional prej 186 persona, u gjetën të akomoduar 230 pacientë me masë mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor” dhe 174 shtetas nën masën e sigurimit personal “Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”. Në nivele më të ulëta mbipopullimi është konstatuar përgjatë monitorimit në qershor 2023⁵⁹, pranë I EVP Vlorë. Sa kohë që të dhënat zyrtare mbi kapacitetin institucional në faqen zyrtare të DPB-së nuk janë të përditësuara, KShH është e paqartë mbi saktësinë e të dhënave të deklaruara nga ana e stafit të institucionit, në raport me ato të publikuara.⁶⁰

8.2 Kushtet infrastrukturore

⁵⁸ Mision monitorimi i ndërmarrë më dt. 1 gusht 2022

⁵⁹ Mision monitorimi i ndërmarrë më dt. 26 qershor 2023 (13 persona mbi kapacitet).

⁶⁰ Në institucion ishin akomoduar 173 persona ndërkohë që kapaciteti i deklaruar nga stafi ishte për 160 persona. Sipas të dhënave të DPB ky institucion ka kapacitet prej 115 persona.

Në kuptim të rëndësisë që ka infrastruktura akomoduese për trajtimin human, KShH vlerëson si pozitiv vendimmarrjet e DPB në vitin 2022, për mbylljen e IEVP-ve me problematika të rënda infrastrukturore, të tilla si Zahari, Vaqarr, Tropojë dhe Sarandë, si dhe masat e marra për ndërtimin e IEVP Pojskë (Pogradec).

Ndërkohë, KShH vërejt se përgjithësisht institucione si IEVP 325 “Ali Demi”, IEVP Burrel, IEVP Peqin, IEVP Lushnjë dhe IEVP Tepelenë, paraqesin godina të amortizuara, të cilat pavarësisht rikonstruksioneve sipërfaqësore nuk garantojnë respektimin e dinjitetit dhe trajtimin human të shtetasve të burgosur/paraburgosur. Prezencë e lagështirës është vërejtur në katet e para të IEVP Fier, ndërkohë që mungesa e dusheve, mos pajisja e klasave me pajisje të nevojshme logjistike, e mungesa e xhamave të dritareve në disa prej qelive është konstatuar në IEVP Fushë-Krujë, ndërkohë rezultuan mungesë e ambienteve rekreative në IEVP Lushnjë dhe IEVP Shënkoll. Godinat nr. IV dhe V të IEVP Shënkoll, të përshtatura për akomodimin e pacientëve nën masë mjekësore, janë projektuar si godina burgu, të pajisura me dyer të rënda metalike, logjistike e cila nuk garanton përmbushjen e standardeve të një institucioni të posaçëm mjekësor.

Në tetor 2022, KShH ka konstatuar se në IEVP Fier nuk sigurohej ujë i pijshëm për të burgosurit, të cilët detyrohen ta blejnë atë.

8.3 Mekanizmi i kërkesë-ankesë

Mekanizmi i brendshëm i trajtimit të kërkesë-ankesave ka shfaqur mangësi të theksuara, kundrejt mos dokumentimit të plotë të procedurave të ndjekura nga ana e stafeve përgjegjëse institucionale, mos përditësimi periodik i të dhënave në regjistrin e dedikuar për këtë qëllim, moskthim përgjigje ndaj shtetasve që ankohen, duke mos garantuar efikasitet dhe transparencë ndaj tyre.

Praktika e krijuar nga IEVP 325 “Ali Demi”, nëpërmjet ngritjes së komisionit të vlerësimit të ankesë/kërkesave dhe funksionimit të tij periodik 2 herë në javë, është pozitive dhe mund të huazohet edhe nga IEVP-të e tjera. Individualizimi i stafit përgjegjës për trajtimin e ankesave dhe kërkesave i shërben rritjes së llogaridhënies të brendshme dhe nxit forcimin e urave të ndërveprimit e bashkëpunimit me shtetasit e burgosur/paraburgosur.

Sa i takon mekanizmit të jashtëm të kërkesë - ankesave të këtyre shtetasve, vlen të përmendet se gjatë vitit 2022, në kuadër të Klinikës së Ligjit kemi ofruar rreth 322 shërbime të ndihmës ligjore falas ndaj kërkues/ankuesve, prej të cilave, afro gjysma e tyre (177) u referuan nga persona të privuar nga liria ose familjarët e tyre. Ndërkohë, gjatë vitit 2023, vërehet një rënie e lehtë e numrit të shërbimeve me rreth 262, ku rreth 44% e ankesë/kërkesave (ose 115) u referuan nga personat e privuar nga liria ose familjarët e tyre. Gjatë këtyre dy viteve, shtetasit e privuar nga liria në sistemin e burgjeve kanë pretenduar më së shumti cënim të procesit të rregullt ose vendime të padrejta gjyqësore, mungesë të garantimit të së drejtës së informimit nga ana e administratës së burgjeve, mosrespektim të së drejtës për jetë private e familjare sa i përket takimeve dhe mosmarrjes në konsideratë të kërkesave për transferim, marrjes së pakove nga familjarët e tyre, si dhe shkëmbim i korrespondencës. Përgjatë vitit 2022 vihet re se numri më i madh i ankesave nga të akomoduarit në institucionet penitenciare, ka

ardhur nga I EVP Burrel⁶¹, Rrogozhinë⁶² dhe Reç.⁶³ E njëjta tendencë e nga të njëjtat I EVP vërehet edhe gjatë 2023.⁶⁴ Shtetasit nën masë mjekësore të akomoduar pranë I EVP Shënkoll janë ankuar më së shumti për konkluzionet e padrejta të ekspertëve të IML-së, të cilat kanë ndikuar në vendimmarrjet e Gjykatave.

Në mënyrë të përsëritur, të burgosurit kanë shprehur shqetësim për mosdhënien e lejeve shpërblyese, që prej përhapjes së Covid-19. KShH ka kërkuar nga DPB reflektim për rishqyrtimin e vendimmarrjes pezulluese, për shkak të përmirësimit të situatës, por nga ana e institucionit nuk ka pasur asnjë reagim.⁶⁵

Një ngjarje e rëndë dhe e paprecedentë u shënuar në sistemin tonë të burgjeve në dt.15 Dhjetor 2023, në I EVP Peqin, ku humbi jetën shtetasi A.Ll. dhe një tjetër bashkëvuajtës mbeti i plagosur. Hetimi i prokurorisë do të shërbejë për zbardhjen e ngjarjes dhe përgjegjësitë për mospërbushjen e detyrimit pozitiv që kanë institucionet penitenciare për të mbrojtur jetën e shtetasve të privuar nga liria. Ankesat e përcjella pranë KShH-së nga të dënuarit e frikësuar nga hakmarrja dhe gjakmarrja, edhe pse në raste të izoluar kanë qenë të vazhdueshme në sistemin e burgjeve. Rrjedhimisht, ato janë këmbanë e mjaftueshme alarmi që autoritetet e burgjeve të marrin masa parandaluese për të siguruar jetën, dhe të shqyrtojnë me kujdesin e duhur çdo pretendim. Gjatë vitit 2023, KShH është përballur me ankesën e përsëritur të dy shtetasve (vëllezër) të akomoduar pranë I EVP Peqin, të cilët pretendonin se ndodheshin në kushtet e kanosjes dhe rrezikut për jetën nga organizata kriminale, të cilët mendohet se mund të kenë kontakte me të burgosur të tjerë të akomoduar në të njëjtën I EVP.⁶⁶⁷ Verifikimi i realizuar nga DPB nxori në pah se pretendimet e tyre janë të përsëritura ndër vite, e që masa konkrete janë marrë për risistemim brenda I EVP-së dhe zëvendësim të personave shpërndarës të ushqimit. Pretendimet e tyre u raportuan nga DPB si të pavërteta, por I EVP Peqin konfirmoi se ka marrë masa për kujdes të shtuar.⁶⁸ Në korrik të vitit 2019, një ankesë tjetër është regjistruar në këtë institucion nga një i dënuar që pretendoi se gjatë kohës së ajrimit është kërcënuar nga ana e një shtetasi në prezencë të punonjësve të sigurisë⁶⁹. Gjithashtu, ai ka kërkuar që të jetë i akomoduar në dhomë vetëm, pasi është i frikësuar nga ndryshimet e shpeshta që bëhen në dhomën e tij dhe që mund të kenë lidhje me problemet e të kaluarës. KShH verifikoi ankesën në I EVP Peqin, dhe pasi e referoi pranë DPB, kjo e fundit vendosi akomodimin e këtij të burgosuri në sektorin e sigurisë së lartë në dhomë vetëm.

8.4 Ri-integrimi dhe rehabilitimi

⁶¹ 37 ankesa.

⁶² 13 ankesa

⁶³ 34 ankesa.

⁶⁴ I EVP Burrel (26 ankesa), I EVP Rrogozhinë (6 ankesa), I EVP Reç (24 ankesa).

⁶⁵ Shkresë nr. 557 prot., dt. 23.08.2023 “Rekomandohet rishikimi i Udhëzimit nr. 6285/1 datë 14/06/2021 ‘Mbi procedurën e vizitave të burgosurve me familjarët në kushtet e pandemisë dhe masave parandaluese’

⁶⁶ Të burgosurit pretendonin se i rrezikohej jeta nëpërmjet ushqimit

⁶⁷ Shkresë nr. 103/1 dt. 01.02.2023 KSHH

⁶⁸ Shkresë nr. 1784/1 prot., dt. 22.02.2023 ‘Kthim përgjigje për ankesën e të dënuarve’

⁶⁹ Si rrjedhojë e përplasjes fizike me të dënuarin tjetër, rezultoi se është ndëshkuar me masë disiplinore, por ndaj qëndrimit të punonjësit të policisë ka bërë me dije se ka vënë në dijeni edhe SHKBB-në.

Misionet tematike të monitorimit të ndërmarrë nga vëzhguesit e KShH-së gjatë vitit 2022, nxorën në pah nevojën për vëmendje të shtuar nga ekipet multidisiplinare të IEVP-ve për hartimin dhe përditësimin sistematik të programeve e planeve të ri-integrimit dhe rehabilitimit për çdo shtetas/e të burgosur.

Vëzhguesit e KShH-së kanë raportuar mungesë të masave për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet të burgosurve dhe familjarëve të tyre, me fokus të veçantë shtetasit e braktisur nga familjet. Praktikrat e vendosura prej përhapjes së Covid-19, ndihmuan edhe më pas shtetasit e privuar nga liria për të zhvilluar takime online me familjarët. Megjithatë, në disa raste janë vërejtur pajisje të kufizuara teknologjike, mos planifikimi i rregullt i orareve të bisedave online, apo mos respektim i kohëzgjatjes së këtyre takimeve konform ligjit, përkatësisht në IEVP Burrel, IEVP Tepelenë dhe IEVP Lushnjë.⁷⁰

Praktika e vendosjes së masave disiplinore ndaj të burgosurve nuk rezultoi e unifikuar në sistemin e burgjeve, ndërkohë që janë vërejtur edhe parregullsi ligjore sa i takon njoftimit të akteve administrative të dala në kuadër të procesit disiplinor dhe saktësisë së plotësisimit të tyre, mungesë e arsytimit të argumentuar të vendimmarrjeve, e mos prezencë dhe në disa raste mos shfaqje e mendimit nga ana e mjekut mbi gjendjen shëndetësore të të burgosurit për përballimin e masës prej tij.

8.5 Të drejtat e personave me probleme të shëndetit mendor

Në Janar të vitit 2020, në çështjen Strazimiri kundër Shqipërisë, GJEDNJ kërkoi ndaj vendit tonë të krijojë “institucionin e duhur” duke pajisur godinat ekzistuese ose ndërtesën e një godine të re të specializuar për strehimin e personave me masë mjekësore “mjekim i detyruar” për përmirësimin e kushteve të jetesës. Por edhe pse kanë kaluar afro 3 vjet nga ky vendim, shteti shqiptar nuk e ka krijuar ende një institucion të tillë, por ka transferuar shtetasit meshkuj me masë mjekësore pranë 2 godinave të IEVP Shënkoll. Përveç problematikave të përmendura më sipër⁷¹ KShH ka vërejtur gjithashtu pamjaftueshmëri të burimeve njerëzore (kryesisht në stafin mjekësor dhe atë psiko-social)⁷². Përgjithësisht, kryerja e vizitave dhe ekzaminimeve mjekësore me kërkesë të vetë pacientëve, nuk garanton ndjekje periodike dhe trajtim të individualizuar shëndetësor. Mosrespektimi i procedurave ligjore në rast të vendosjes së këtyre shtetasve në kushtet e kufizimit fizik, përkundërt cënimit të afatit 24 orë, nuk i shërben trajtimit të kësaj mase si të një natyre përjashtuese e të përkohshme.

Në korrik 2022, vëzhguesit e KShH-së vlerësuan pozitivisht praktikën e vendosur nga IEVP Burrel, për mos caktimin e asnjë mase disiplinore ndaj shtetasve të diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor. Përfshirja e kësaj kategorie të shtetasve të burgosur në këtë IEVP, në marrjen pjesë proaktivisht në aktivitete rekreative, i shërben procesit të riintegrimit dhe rehabilitimit të tyre.

⁷⁰ Në këto IEVP u vërejt aksesi gjatë harkut kohor 15-30 min në pajisjen kompjuterike, përkundërt periudhës 1 orë që është parashikuar nga legjislati.

⁷¹ Misioni monitorues u ndërmor më dt. 23.03.2023

⁷² Sipas organikës së miratuar të IEVP Shënkoll, në sektorin shëndetësor duhet të jenë të punësuar 22 punonjës, ndërkohë që janë konstatuar 5 vakanca në pozicionin e mjekut kardiolog, mjek psikiatër, mjek laborant klinik biokimik dhe infermier(2).

Gjithashtu, janë konstatuar 3 vakanca sa i takon pozicionit “kujdestar për pacientët me masë mjekësore”.

Trajtimi i shtetasit Q.H., i cili i dha fund jetës në muajin shtator 2023 në ambientet e I EVP Lezhë ndërkohë që ekzekutonte dënimin e konvertuar ndaj tij me masë mjekësore, nxori në pah një ndjekje shëndetësore jo sistematike nga ana e personelit mjekësor. Trajtimi i ofruar ndaj tij në masë farmakologjike, ishte shoqëruar me aktivitete të kufizuara rekreative, sipas kërkesës dhe dëshirës së tij. Paralelisht, mos përfshirja e stafit institucional me uniformë në trajnime për mirë-menaxhimin e rasteve të urgjencave, siç janë edhe vetëvrasjet, nuk i ka shërbyer neutralizimit dhe as reduktimit të pasojave psikologjike për vetë ata.

Rreth 1 muaj më vonë, KShH verifikoi në I EVP Drenovë (Korçë), ankesën e të burgosurit të diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor, I.J., që pretendoi masë të padrejtë të vendosjes në sektorin e mbikëqyrjes së veçantë, pasi pretendonte se ishte mbajtur prej afro 6 ditësh nën ushtrimin e forcës dhe neutralizimin me pranga nga ana e stafit institucional. Vëzhguesit e KShH-së raportuan se vendimi i marrë ndaj të burgosurit ishte arbitrar dhe i kundërligjshëm, pasi autoritetet e burgut kishin dështuar në argumentimin e nevojës për vendosjen e kësaj mase kundrejt rrezikut që mund t'i shkaktonte vetes apo të tjerëve i dënuari. Ndërkohë, përdorimi i prangave dhe lidhja me zinxhirë, të konfirmuara nga dëshmitë e bashkëvuajtësve të tjerë dhe përfaqësuesve të stafit, ishte i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të CPT-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së.⁷³

8.6 Të miturit në konflikt me ligjin

Në vizitën monitoruese në ambientet e IM Kavajë në Shkurt 2023, vëzhguesit e KShH-së vërejtën se krahas problematikave të kushteve fizike si rrjedhojë e erës së rëndë të mykut në ambientet e tualeteve të përbashkëta, lagështirës në nivele minimale sanitare e higjienike, u vërejt se organika institucionale funksionale është 3 herë më e lartë në raport me shtetasit e mitur të vendosur në këtë institucion.⁷⁴ Problematikë shqetësuese është forma dhe mënyra e transportimit të të miturve me prezencën e të rriturve, në të njëjtin automjet e për një kohë të gjatë tranzit në burgjet e kryeqytetit, për ndjekjen e seancave gjyqësore. Forcimi i urave të bashkëpunimit ndërmjet DPB dhe KLGJ vlerësojmë se do të ndihmonte në gjetjen e zgjidhjeve eficiente e të përshtatshme për përfshirjen e të miturve në proceset gjyqësore.

8.7 Advokimi me institucionet e sistemit penitenciar

Përgjithësisht, KShH ka konstatuar se I EVP-të e monitoruara pas njohjes me gjetjet dhe rekomandimet e përcjella në mënyrë sistematike nga KShH në rrugë zyrtare, kanë zgjedhur heshtjen institucionale. Përyjashtimisht, praktika pozitive të reagimit janë vërejtur në I EVP 325 “Ali Demi”⁷⁵ e cila u përgjigj në mënyrë të arsyetuar ndaj rekomandimeve të KShH-së, si dhe IM Kavajë, I EVP

⁷³ https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/10/AHC-Deklarate_Nje-ngjarje-e-rende-ne-Burgun-e-Drenoves.pdf

⁷⁴ Nga informacioni i vënë në dispozicion rezulton se organika e miratuar nga ana e DPB-së përbëhet nga 80 persona, por në ditën e monitorimit 71 punonjës ushtronin funksionin në institucion. 31 prej këtyre punonjësve ishin pjesë e administratës civile, ndërkohë që stafi me uniformë përbëhej nga 40 punonjës. Vakanca u konstatuan në administratën civile në funksionin 1 mirëmbajtës dhe 1 farmacist, ndërkohë që stafi me uniformë ishte i paplotësuar në 8 pozicionet e punonjësve të rolit bazë (5 vende vakante grada inspektor; 2 vende vakante n/inspektor; 1 vend vakant k/inspektor). Vakanca e farmacistit në institucion mbulohej përkohësisht nga ana e njërit prej infermierëve.

⁷⁵ Pas vizitës monitoruese të ndërmarrë më dt. 20.10.2022

Lezhë dhe IEVP Elbasan, që hartuan plane konkrete masash për përmbushjen e atyre sugjerimeve të pranuar prej tyre.⁷⁶

Prej muajit qershor 2023, KShH ka vërejtur një qasje më proaktive reaguese të Ministrisë së Drejtësisë, e cila i është drejtuar institucioneve objekt monitorimi, duke kërkuar prej tyre informim në vijimësi lidhur me ecurinë dhe nivelin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të adresuara.⁷⁷

9 Monitorimet e kryera në Komisaritet e Policisë

Përgjatë viteve 2022-2023 KShH ka realizuar 5 misione monitorimi, në Komisaritet e Policisë, ku për tre nga rastet është reaguuar publikisht. Në 2 ngjarje të verifikuara në vitin 2022⁷⁸ dhe në 1 ngjarje të ndodhur në vitin 2023⁷⁹, shtetasit e akomoduar në ambientet e Komisariateve apo nën kontrollin/shoqërimin e punonjësve të Policisë, humbën jetën. Këto ngjarje shtrajnë nevojën për adresimin e problematikave sistematike në Policinë e shtetit, ndër të cilat nevoja për rekrutimin meritokratik, promovimin e karrierës së qëndrueshme e mbështetjen me trajnime vazhduese të stafit, kontrollet periodike mjekësore, fuqizimin e mekanizmit kërkesë-ankesë dhe ofrimin e mbështetjes së nevojshme psiko-sociale ndaj të arrestuarve në flagrancë, të ndaluarve apo edhe shoqëruarve.

9.1 Mbipopullimi

Në misionet monitoruese të KShH-së të realizuara kryesisht gjatë organizimit të protestave e tubimeve masive të qytetarëve, gjatë vitit 2022, u vërejt se Komisariti i Policisë nr. 5 (Kamëz)⁸⁰ dhe DVP Tiranë nuk garantojnë kushtet e hapësirën e përshtatshme akomoduese për një numër të madh të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar në flagrancë.⁸¹ Si rrjedhojë, shtetasja Gj.B pretendoi se 11 shtetas kanë qëndruar në të njëjtën dhomë, gjatë arrestimit në flagrancë e qëndrimit në ambientet e DVP Tiranë dhe e kaloi natën duke fjetur në një shtresë sfungjeri, të shtruar mbi dysheme.

9.2 Kushtet infrastrukturore

Gjatë monitorimeve të vitit 2022, është konstatuar mungesa e ambjenteve të përshtatshme akomoduese në Komisaritet e Tiranës. Rastet më shqetësuese janë evidentuar nga monitorimet e kryera pranë DVP Tiranë, Komisariti Nr. 3 (Rruga Mine Peza) dhe Komisariti Nr. 5 (Kamëz)⁸², ku janë vërejtur kushte të vështira higjeno-sanitare, mungesë e ajrimit të mjaftueshëm, mungesës së dritës natyrale dhe mungesës së sistemit të ngrohjes. Gjithashtu, problematikë janë evidentuar

⁷⁶ Shkresë nr. prot. 1138 date 25.03.2023 e IEVP Elbasan dhe Shkresa nr. 284 prot. datë 13.04.2023 e IM Kavajë

⁷⁷ Shkresa përcjellëse nga ana e MD-së që i korrespondojnë misioneve monitoruese të ndërmarrë nga KShH në IEVP Lezhë më dt. 23.03.2023, në IEVP Korçë më dt. 21.06.2023, në IEVP Burrel më dt. 09.08.2023 dhe IEVP Rrogozhinë më dt. 23.08.2023

⁷⁸ <https://ahc.org.al/deklarate-per-shtyp-ngjarja-tragjike-ne-komisariat-in-e-kavajes-mund-te-parandalohet/>
<https://ahc.org.al/njoftim-per-shtyp-26/>

⁷⁹ https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/05/Fin_Raport_-_Monitorimi-i-te-drejtave-dhe-lirive-te-Shtetasit-te-Minoritetit-Rom-J.R_.pdf

⁸⁰ Monitorim i ndërmarrë më dt. 11.03.2022

⁸¹ https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/03/Raport-Monitorimi_-_Protesta.pdf

⁸² Misione monitorimi në datë 11 Mars 2022

procedurat e transferimit të disa protestuesve nga Komisaritet e Policisë nr. 1, 2 dhe 3 në Tiranë, drejt Komisariateve të Policisë Elbasan, Kavajë apo dhe Kamëz, për shkak të mungesës së hapësirave akomoduese. Tashmë me funksionalizimin e plotë të Bllokut të Sigurisë së DVP Tiranë, kushtet e të cilit janë verifikuar gjatë këtij viti⁸³, vlerësohet se kjo problematikë konsiderohet e zgjidhur.

9.3 Afatet dhe të drejtat procedurale të shtetasve të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar në flagrancë

Monitorimet e KShH gjatë viteve 2022-2023⁸⁴, nxorën në pah parregullsitë procedurale në mënyrën e plotësimit të dokumentacionit standard, mungesë të kontrollit mjekësor në momentin e pranimit dhe atij periodik të personave të ndaluar/arrestuar gjatë kohës së qëndrimit në ambientet e Komisaritetit, si dhe mosrespektim i të drejtave të shtetasve të mitur në konflikt me ligjin sa i përket njoftimit të familjarëve.⁸⁵

Vonesa në transportimin urgjent drejt ambienteve spitalore civile u konstatuan në rastin e të arrestuarit L.K., i cili humbi jetën pas shoqërimit në Komisaritetin e Policisë nr.3 Tiranë. Por pavarësisht nga shkeljet e konstatuara në reagimin publik të KShH-së⁸⁶, pas më shumë se një viti nga kjo ngjarje, Prokuroria e Tiranës i kërkoi gjykatës pushimin e çështjes⁸⁷. Në kundërshtim me detyrimin ligjor për realizimin e transferimeve vetëm gjatë ditës, shtetasja Gj.B, u transportua nga Komisariteti i Policisë nr. 3, drejt DVP Tiranë rreth orës 22.00 të mbrëmjes. Mosrespektimi i kushteve të sigurisë konform standarteve të përcaktuara në aktet e Policisë së Shtetit në ambientet e dhomave të sigurisë në Komisaritetin e Policisë Kavajë, krijonte mundësinë për kryerjen e aktit të vetëvrasjes, sikurse ndodhi me të arrestuarin I.M⁸⁸. Lidhur me këtë ngjarje, KShH konstatoi gjithashtu mungesë të mbikqyrjes së duhur dhe masave parandaluese nga punonjësit e policisë ndaj gjendjes së rënduar emocionale të I.M, në momentin fillestar të pranimit në institucion. Periodikisht në të gjitha misionet e verifikimit të realizuara në Komisaritetin e Policisë, KShH ka evidentuar parregullsi në ushtrimin e rolit dhe respektimit të parimeve deontologjike nga ana e mjekut, si në mos dokumentimin e qartë dhe objektiv të shenjave të dëmtimit fizik në trupin e të shoqëruarve/arrestuarve⁸⁹, apo mos prezencën në momentin e pranimit në institucion e kontrollin periodik të gjendjes shëndetësore.

9.4 Advokimi me institucionet e Policisë së Shtetit

⁸³ Misione verifikimi të ndërmarra me 3 - 4.05.2023

⁸⁴ Pranë DVP Tiranë, Komisaritetit të Policisë nr. 2, 3 dhe 5 në Tiranë

⁸⁵ Të dhëna të verifikuara gjatë misionit të ndërmarrë më dt. 11.03.2022 pranë Komisaritetit të Policisë nr. 3 (Tiranë)

⁸⁶ <https://ahc.org.al/njoftim-per-shtyp-26/>

⁸⁷ <https://shqiptarja.com/lajm/lear-kurti-vdiq-nga-mbidoza-prokuroria-e-tiranes-pushon-ceshtjen>

⁸⁸ Konkretisht shufra metalike horizontale e zgavrës së qelisë nuk duhet të ishte më e lartë se 60 cm. Në fakt ajo ishte vendosur në një lartësi rreth 2 metër, gjë që krijonte mundësinë e vetëvarjes. <https://ahc.org.al/deklarate-per-shtyp-ngjarja-tragjike-ne-komisariatin-e-kavajes-mund-te-parandalohej/>

⁸⁹ Gjatë misionit të monitorimit në datën 11 Mars 2022 pranë DVP Tiranë, shtetasja e arrestuar në flagrancë GJ.B, pretendoi se gjatë shoqërimit, ndaj saj janë kryer veprime të dhunshme nga punonjësit e policisë. Vëzhguesit e KShH-së nga qyryja pamore evidentuan shenja të dukshme, gërvishtje dhe shenja të tjera në pjesën e parakrahut. Konstatimi i shenjave të dëmtimit fizik ishte dokumentuar në procesverbalin e konstatimit të përpiluar nga mjeku, në orën 01:30, dt. 11.03.2022, si dhe në Librin e Vizitave Mjekësore (nr.rendor 473). Nga qyryja e dosjes personale të kësaj shtetaseje, u vërejt se mungonte kartela mjekësore me shënimet përkatëse të mjekut

Gjatë periudhës objekt i këtij raporti, pavarësisht nga reagimet publike të vazhdueshme të KShH-së sa i takon shkeljeve të konstatuara në monitorimet e Komisariateve të Policisë, është për t'u përshëndetur qasja pozitive reaguese nga DPPSh. Ky institucion ka reaguar, duke komunikuar gatishmërinë në marrjen e masave organizative për ndjekjen e rekomandimeve/sugjerimeve të adresuara nga KShH.

Në korrik 2023, në vijim të gjetjeve të përcjella nga KShH për mos garantim të respektimit të të drejtave të të ndjerit J.R., i cili humbi jetën në ambientet e QSUT-së, pas arrestimit e qëndrimit në Komisaratin e Policisë nr. 3 (Tiraën), Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit lëshoi një letër porosi ndaj strukturave vendore për trajtimin mjekësor të personave, me fokus të veçantë përdorues të dozës së mjekimit 'metadon'.⁹⁰

Gjithashtu KShH vlerëson masat e marra nga DPPSh në drejtim të përmirësimit të kushteve infrastrukturore të zyrës së mjekut pranë DVP/Komisariatit të Policisë Korçë⁹¹ apo referimin nga strukturat eprore të policisë së shtetit të pretendimeve për ushtrim dhune ndaj të shoqëruarve të mitur gjatë një përbaljeje me punonjësit e policisë pranë rrugës Myslym Shyri në tetor 2022, përkatësisht pranë Prokurorisë dhe Drejtorisë së Standardeve Profesionale.⁹²

10 Të drejtat e azilkërkuesve dhe migrantëve

Në prill 2022, KShH publikoi një letër të hapur⁹³ drejtuar Ministrisë së Brendshme mbi përjashtimin e paargumentuar dhe të pabazuar të përfaqësuesit/es të KShH-së nga Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët. Më herët, KShH pasi ishte njohur me projekt-vendimin e KM, e ku anëtarësia e tij në përbërje të Komisionit vijonte të figuronte nuk kishte shfaqur kundërshtime lidhur me këtë parashikim. Por më vonë, në mënyrë kontradiktore, KM nëpërmjet vendimit nr. 669, dt. 10.11.2021 ndryshoi përbërjen e Komisionit, duke zhveshur nga anëtarësia përfaqësuesin e shoqërisë civile (KShH).⁹⁴ Vlen të theksohet, se gjatë periudhës së anëtarësisë së KShH në Komision, nga 8 raste të shqyrtuara mbi bazën e ankesave të azilkërkuesve, në 5 raste është mbajtur qëndrim në pakicë, në favor të respektimit të të drejtave të këtyre shtetasve.

Gjatë interpelancës së realizuar në Kuvend në muajin Prill 2022, Ministri i Brendshëm i asaj kohe, bëri të ditur se KShH dhe organizatat e shoqërisë civile mund të marrin pjesë në rolin e vëzhguesit në mbledhjet e Komisionit. Por në fakt, gjatë vitit 2022-2023, KShH nuk është ftuar në asnjë mbledhje të realizuar nga Komisioni.

⁹⁰ Shkresë nr. 4772/1 prot., dt. 27.07.2023 "Mbi zbatimin e rekomandimeve të KShH-së, lidhur me monitorimin për rastin e qytetarit J.R.", lëshuar nga Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

⁹¹ Shkresa nr. 7436/1 prot. datë 02.12.2022 e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së shtetit drejtuar KShH-së

⁹² Shkresë nr. 15793/3 prot., dt. 02.11.2022 "Kthim përgjigje tuajës nr. 509, dt. 12.10.2022" të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

⁹³ https://ahc.org.al/leter-e-hapur-komiteti-shqiptar-i-helsinkit-perjashtohet-pa-arsye-nga-anetaresia-ne-komisionin-kombetar-per-azilin-dhe-refugjatet/#_ftn3

⁹⁴ Katër ministri -Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit- dhe një përfaqësues nga Shërbimi Informativ Shtetëror

KShH evidenton një rritje të lehtë të kërkesave për azil, por vetëm një pjesë e vogël e të huajve kanë fituar mbrojtje ndërkombëtare në vendin tonë. Konkretisht, 24 persona kanë përfituar nga totali prej 125 kërkesave të depozituara për mbrojtje ndërkombëtare gjatë vitit 2022, si dhe në 7 mujorin e vitit 2023 janë regjistruar 123 kërkesa por vetëm 11 persona kanë përfituar mbrojtje. Të dhënat zyrtare të përcjella reflektojnë se gjatë periudhës 2022 dhe 2023 ka patur persona⁹⁵ që kanë ndërprerë procedurat për mbrojtje ndërkombëtare duke u larguar nga Qendra Pritëse. Paralelisht, autoritetet e azilit raportojnë se gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 dhe Janar-Korrik 2023, përpara shqyrtimit nëpërmjet procedurës së kërkesës së tyre për azil, rreth 3,137 shtetas afganë kanë tërhequr kërkesën e tyre për mbrojtje të përkohshme dhe janë larguar me dëshirë nga vendi ynë.

Në vitin 2023, rruga e migracionit të parregullt në Ballkanin Perëndimor ka pasur disa ndryshime, duke përfshirë rënien e flukseve migratore dhe rritjen e përdorimit të rrugës së Mesdheut Qendror nga migrantët e parregullt dhe kontrabandistët. Autoritetet vendase, raportojnë se vijnë të mbeten vendkalimet kryesore të migracionit të parregullt, rajoni i Korçës, kryesisht në zonën e Kapshticës; rajoni i Gjirokastrës, kryesisht në zonën e Kakavijës dhe rajoni i Sarandës, kryesisht në zonën e Konispolit (drejtim Qafë Botë). Kufiri me Greqinë mbetet një zonë problematike. Kryesisht migrantët e parregullt të kapur në territorin e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë të ardhur nga Bangladeshi, Afganistani, Algjeria, Eritreas, Siria, Somalia dhe Nepali.

Referuar të dhënave të një kampioni të vendimeve gjyqësore të studiuara për vitet 2015-2021⁹⁶, kontrabandistët shqiptarë janë përfshirë në operacione të organizuara të ndihmës së kalimit të paligjshëm të kufirit kundrejt pagesave tepër të larta që janë paguar nga migrantët, duke variuar nga 5000 deri në 8000 euro. Është pozitiv fakti se në shumicën dërrmuese, gjykatat nuk kanë dhënë dënime penale për të huajt që janë ndihmuar për të kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme, duke reflektuar praktikën e mira dhe standartet ndërkombëtare për përjashtimin e tyre nga ndjekja penale.

Në Shkurt 2023, misioni i vëzhguesve të KShH-së u ndërpre nga Qendra Kombëtare Pritëse Babrru, ku janë të akomoduar azilkërkuuesit. Shkak sipas autoriteteve ishte argumenti se mungonte autorizimi i drejtpërdrejtë nga Ministria e Brendshme. Në 2 dekadat e fundit, cikli i misioneve monitoruese në këtë institucion ishte realizuar bazuar në Marrëveshjen e KShH-së me DPPSH-në. Prej muajit tetor 2023, draft-marrëveshja është në proces të brendshëm konsultimi me Ministrinë e Brendshme. Formalitete të tilla që zgjasin pengesat për proceset e monitorimit nga KShH, e cila ka drejtim kryesor të misionit të saj vëzhgimor dhe të drejtave dhe lirive të njeriut, përbëjnë një pengesë në ushtrimin e lirisë organizative të KShH-së.

Në Mars 2023, gjatë misionit monitorues të KShH-së në Qendrën e Mbyllur Kareç, ku mbahen të ndaluar migrantët e parregullt të kapur në territorin tonë u konstatuan kushte të papërshtatshme infrastrukturore, si prezencë shqetësuese e lagështirës, erë e rëndë myku, mungesë e

⁹⁵ 18 persona gjatë 2022 dhe 3 persona gjatë Janar - Korrik 2023.

⁹⁶ https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2023/12/Raport_Fenomeni-i-kalimit-te-paligjshem-te-kufirit-dhe-ndihmes-ndaj-tij-nen-Perspektiven-e-Gjykatave-te-Rretheve-Gjyqesore.pdf

ngrohjes ambientale, tavane të amortizuara si dhe mungesë të sistemit kartofonik për zhvillimin e telefonatave të huajve me familjarët e tyre⁹⁷.

Pas njohjes me Protokollin e nënshkruar mes Shqipërisë dhe Italisë, për përdorimin e territorit shqiptar për krijimin e zonave të destinuara për pritjen dhe mbajtjen e refugjatëve azilkërkues, KShH i është bashkuar thirrjes së 28 organizatave e aktivistëve të shoqërisë civile, duke shprehur shqetësimin serioz për shkeljet e të drejtave dhe lirive të azilkërkuesve që migrojnë drejt Italisë dhe kanë si vend origjine shtetet Afrikane, mungesën e konsultimit publik dhe transparencës për vendimmarrje të tilla me interes të lartë publik, si dhe duke kërkuar rishqyrtimin dhe tërheqjen e vendit tonë nga ky Protokoll.⁹⁸

11 Lufta kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Gjatë viteve 2022-2023, KShH ka patur një marrëdhënie pozitive bashkëpunimi me autoritetet e burgjeve për përmirësimin e protokolleve të brendshme dhe rritjen e kapaciteteve të stafit penitenciar mbi parandalimin e identifikimin e hershëm të akteve radikaliste dhe ekstremiste të ndërmarra nga shtetas të privuar nga liria si dhe rehabilitimin e personave të radikalizuar.

Nevoja për nxitjen e bashkëpunimit të brendshëm të ekipit multidisiplinar, forcimi i partneritetit ndërsektorial e ndërinstucional, fuqizimi i rolit të punonjësit dhe monitorimi i respektimit të procedurave ligjore e ndërveprimit të ndërsjelltë ndërmjet stafit dhe të burgosurit, e rritja e kapaciteteve vazhduese të stafit, dolën si sugjerime të pjesëmarrësve, pjesë e stafit të 8 IEVP-ve të trajnuar nga KShH gjatë periudhës korrik-gusht 2023.

Sipas rregullimeve të legjislationit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, gjatë procesit të rehabilitimit dhe riintegritit të luftëtarve të huaj dhe familjarëve të tyre të kthyer në Shqipëri, duhet të sigurohen standardet më të larta të shëndetit, trajtimit, rehabilitimit dhe riintegritit për të miturit, duke ofruar një shërbim të personalizuar dhe të specializuar, në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Ruajtja e konfidencialitetit për të dhënat personale të individëve subjekt i proceseve rehabilituese dhe riintegruese është një aspekt delikat që kontribuon drejtpërdrejt në sigurimin e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave të njeriut gjatë procesit të riintegritit në shoqëri, si dhe në suksesin e këtyre proceseve. Përmirësimi i sistemeve për mbledhjen, ruajtjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit që i përket kategorive të luftëtarëve të huaj dhe familjarëve të tyre të kthyer, si dhe individëve të prekur nga fenomenet e ekstremizmit të dhunshëm ose radikalizmit, vlerësohet si një ndërhyrje e rëndësishme për sigurimin e mbajtjes së sigurt të informacionit, analizimin e tij dhe bashkëveprimin efektiv me agjenci dhe institucione të tjera ligjzbatuese, brenda dhe jashtë vendit.

12 Gjuha e urrejtjes së grupeve të marginalizuara

⁹⁷ Në konsultimin e përbashkët të dt. 8 nëntor 2023 (rreth 8 muaj më vonë), përfaqësuesit e autoriteteve përgjegjëse bënë të ditur se janë marrë masa për ristrukturimin infrastrukturor të godinës e adresimin e rekomandimeve të KSHH, elementë që vlen të verifikohen në vijimësi nga KSHH.

⁹⁸ https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid02dvfY2GhXcYFkEAh6xYzzEËQF38fË153FsEXTyRha9seSzH7bVcXDGr5PFggëNhHNI&id=100064874522900&mibextid=Nif5oz

Përdorimi i gjuhës së urrejtjes vijon të jetë shqetësues sidomos në hapësirën digjitale dhe në mediat sociale. Kryesisht forma të ndryshme të gjuhës së urrejtjes motivohen më së shumti nga orientimi seksual, përkatësia fetare, përkatësia etnike dhe bindjet politike (për këto të fundit trendi rritës reflektohet gjatë procesit para zgjedhor)⁹⁹. Ndryshimet ligjore në vitin 2021 në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, ishin të rëndësishme pasi i dhanë statusin e titullit ekzekutiv vendimmarrjeve me masë administrative të KMD-së, duke e diferencuar pozitivisht vendin tonë në raport me rajonin. KShH vlerëson se pro-aktiviteti dhe rastet e filluara me iniciativë nga KMD dhe AMA duhet të rriten kur konstatohen elementë të gjuhës së urrejtjes në median audiovizive.

Përgjatë vitit 2023, KShH ka konstatuar individë apo edhe gazetarë që kanë tejkaluar lirinë e shprehjes dhe ka bërë thirrje për ndaljen e gjuhës së urrejtjes dhe asaj denigruese në media me elementë të presionit ndaj organeve të drejtësisë.¹⁰⁰

13 Liria e Organizimit

Rezoluta e miratuar nga ana e Kuvendit të RSH në 2019 “Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut” vijon të mbetet një akt formal, ndërkohë që përkundrejt parashikimeve të saj, N/Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut nuk ka zhvilluar vlerësime të monitorimit të zbatueshmërisë së kësaj Rezolute.

Liria e organizimit nuk do të ishte efektive nëse institucionet shtetërore nuk do të tregonin një qasje të hapur në drejtim të përfshirjes dhe konsultimit të organizatave në procese vendimmarrëse me rëndësi për misionin dhe veprimtarinë e tyre si dhe për publikun, dhënies së informacionit konform legjislacionit në fuqi, krijimit të kushteve pa pengesa joproportionale, për të vëzhguar situatën e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe pranimit në mënyrë konstruktive të rolit kritikues që organizatat kanë, sidomos ato që monitorojnë prej vitesh institucionet. Por sikurse është analizuar në pjesë të tjera të këtij raporti, të tri këto komponentë reflektojnë një qasje të mbyllur të institucioneve dhe ekzistencën e një klime paragjyquese dhe penguese ndaj organizatave për ushtrimin e misionit të tyre për sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Gjatë vitit 2022, KShH ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve dhe sensibilizimin e aktivistëve të rinj të të drejtave të njeriut, drejt parimeve themelore të të drejtave të njeriut dhe përfshirjen e tyre në një rol proaktiv si vëzhgues të nivelit të respektimit të lirive themelore mbi bazën e të cilave raportohet pranë Rishikimit Periodik Universal (UPR), mekanizmit të veçantë të Këshillit për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara.

Përkundrejt tendencës tkurrëse me të cilën po përballet sektori i shoqërië civile në rajon e më gjerë, është pozitiv fakti se organizatat vendase, ato rajonale dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile po bashkëpunojnë për të adresuar format e duhura të reagimit kundrejt lirisë së organizimit dhe të

⁹⁹ Gjatë vitit 2022 KShH ka evidentuar 21 raste të përdorimit të gjuhës së urrejtjes për shkak të orientimit seksual, 13 për shkak të përkatësisë etnike, 8 për shkak të bindjeve politike si dhe 6 raste për shkak të përkatësisë fetare. Deri në nëntor 2023, janë evidentuar 8 raste të gjuhës së urrejtjes për shkak të përkatësisë etnike, 3 për shkak të përkatësisë fetare, 12 si rrjedhojë e orientimit seksual apo identitetit gjinor dhe 16 raste si rrjedhojë e bindjeve politike.

¹⁰⁰ <https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/posts/pfbid02qjJXPZVZirFoAU7Tx3FRFUmqhtt54YaMncZGKRRXhv7q2EDpssuRUG1T2XEHYTQI>

drejtave dhe lirive të njeriut. KShH bashkë me partnerët ka reaguar për kauza të rëndësishme lidhur me të drejtat e liritë e njeriut, të tilla si liria e zgjedhjeve, e organizimit, lufta ndaj korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm.¹⁰¹

Në mbrojtje të lirisë organizative, KShH së bashku me 4 organizata të shoqërisë civile (CRD, Birn Albania, Aleanca LGBT dhe KSHM) dërguan një kërkesë në Janar 2023 në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e disa prej dispozitave të ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”¹⁰². Në Nëntor 2023, Gjykata Kushtetuese vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës duke shfuqizuar disa prej parashikimeve që krijojnë efekt tkurrës për mjedisin e shoqërisë civile dhe lirinë e organizimit në vendin tonë.¹⁰³

14 E drejta për Informacion

Situata e zbatimit të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” vijon të jetë problematike në vendin tonë, duke reflektuar një qasje në tërësi jo transparente të institucioneve publike. Nga praktika e kërkimit të informacionit të KShH-së, viti 2023 shënon një regres të mëtejshëm në raport me 2022, pasi vihet re që institucionet përgjigjen me vonesë ose pjesërisht ndaj objektit të kërkesës dhe vetëm pas vënies në lëvizje të Komisionerit arrihet deri diku marrja e informacionit¹⁰⁴. Roli i Komisionerit vijon të jetë ndërmjetësues, ndërkohë që për ankesat e adresuara nuk jepen sanksione ndaj “përsëritësve” të shkeljes së ligjit nr.119/2014.

Bazuar në praktikën e KShH-së, vërehet se vonesat prej më shumë se një viti që krijohen si rrjedhojë e kundërshtimeve prej institucioneve, në gjykatë, të vendimmarrjeve pozitive të Komisionerit në favor të së drejtës për informimit dëmtojnë thelbin e të drejtës së informimit në afate të arsyeshme, duke dobësuar aktualitetin e informacionit të kërkuar¹⁰⁵. KShH thekson nevojën për prioritizimin e shqyrtimit gjyqësor të këtyre ankimeve në afate të arsyeshme, nga sistemi ynë gjyqësor.

¹⁰¹ <https://ahc.org.al/gjykata-kushtetuese-shfuqizon-pjeserisht-disa-prej-dispozitave-te-ligjit-nr-80-2021-per-regjistrimin-e-organizatave-jofitimprurese/>
<https://ahc.org.al/leter-e-hapur-apel-per-rishqyrtim-te-marreveshjes-se-imigracionit-me-italineleter-e-hapur/>
<https://ahc.org.al/njoftim-per-shtyp-thirrje-e-nje-grupimi-te-organizatave-shqiptare-te-shoqerise-civile/>
<https://ahc.org.al/reagim-i-perbashket-i-nje-grupimi-organizatash-te-shoqerise-civile-per-zgjedhje-te-lira-dhe-te-ndershme/>
<https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/posts/pfbid0kZCGM629qRmc1JiK7jR37hcVE7z1f3PVmbB83DfZkG4sDQëPfkBpLrv8ag4ësXXRI>

¹⁰² Me argumentin se ato cenonin të drejtën kushtetuese për t'u organizuar, të parashikuar në nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 11 të KEDNJ në kundërshtim me parashikimet e nenit 17 të Kushtetutës dhe me standardet ndërkombëtare

¹⁰³ https://www.gjk.gov.al/ëeb/NJOFTIM_VENDIMARRJEJE_2848_1-94.php

¹⁰⁴ Në raport me vitin 2022 (8 ankime administrative), në vitin 2023 vërehet një rritje 2-fish (16 raste) e numrit të ankimeve administrative të adresuara nga KShH pranë zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP)

¹⁰⁵ Pas shqyrtimit të ankimit të depozituar nga KShH në fund të vitit 2022, ndaj organit të vettingut (KPK), për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, Komisioneri vendosi në favor të KShH-së, duke detyruar autoritetin publik për dhënien e informacionit. Ankimimi i kësaj vendimmarrjeje nga KPK, ka bërë që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë të shpallë dhe përcaktojë muajin Shkurt 2024, si datë për realizimin e seancës së parë.

Të dhënat personale vijnë të jenë të cënueshme si rezultat i rrjedhjeve apo sulmeve online të vendeve të tjera, sikurse ka qenë në rastin e Iranit, por përgjegjësitë lidhur me to nuk hetohen në mënyrë të plotë.

Rrjedhet masive të të dhënave personale në vitin 2021, u analizuan thellësisht nga KShH një vit më pas, duke evidentuar hetime të pjesshme, jo efektive dhe pandëshkueshmëri në nivele të ulëta, si në aspektin administrativ ashtu edhe në atë penal.¹⁰⁶ Ndërkohë, në gusht të vitit 2023, u publikua lajmi i rrjedhjes së të dhënave nga sistemi TIMS, i cili bëhet e ditur se është kthyer për veprime shitesë nga Prokuroria e Tiranës pranë Agjencisë së Mbikqyrjes Policore (AMP).¹⁰⁷ Mungesa e transparencës kundrejt publikut mbi vijueshmërinë e hetimit të këtij procesi konsiderohet jo pozitive në favor të luftës kundër krimit të organizuar dhe rritjes së llogaridhënies e përgjegjshmërisë së punonjësve me uniformë.

Ndryshimet e miratuara nga Kuvendi në paketën e ligjeve për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale iu nënshtruan konsultimit publik nga Ministria e Drejtësisë. Pozitiv është fakti se u morën në konsideratë pjesërisht sugjerimet e adresuara nga KShH, ndër të cilat shfuqizimi i dispozitës mbi kërkesat abuzive, angazhimin e Komisionerit për propozimin e deklasifikimit të informacionit kur çmon që publikimi i tij diktohet nga interesa më të rëndësishme shtetërore dhe publike, dhe qartësimi i pamundësisë objektive të njohimit të titullarit të institucionit.

15 Liria e shprehjes

15.1 Liria e Medias dhe të drejtat e gazetarëve në vendin e punës

Bazuar në të dhënat e sondazhit me punonjësit e medias, të përpunuara në formën e Barometrit mbi Lirinë e Medias në vend, u konfirmua gjendje jo e mirë e medias dhe lirisë së shprehjes.¹⁰⁸ KShH sheh me shqetësim rritjen e rasteve të kërcënimit fizik dhe verbal ndaj gazetarëve e punonjësve të medias. Vijon të jetë shqetësues fakti se afro një në dy gazetarë ndihen të censuruar nga struktura hierarkike dhe drejtuese e redaksisë dhe po kaq prej tyre kanë pësuar vetë-censurë. Ndërkohë, pjesa më e madhe e të anketuarve apo 68% e tyre (2.5% më shumë se vitin e shkuar) perceptojnë se media në Shqipëri është pak ose aspak e lirë. Përfaqësues të politikës në nivel qendror apo vendor mbeten sërish censuruesit dhe kufizuesit kryesorë të lirisë së medias sipas të anketuarve, të ndjekur sërish nga pronarë të mediave, përfaqësues të strukturave shtetërore, kryesisht ato policore dhe persona të identifikuar si të përfshirë apo implikuar në krim.

¹⁰⁶ <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/07/komiteti-shqiptar-i-helsinki-dokument-politikash-dhe-qendrimesh-mbrojtja-e-te-dhenave-personale.pdf>

¹⁰⁷ <https://shqiptarja.com/lajm/kallezimi-i-amp-per-sistemin-tims-prokuroria-e-tiranes-materialet-e-dorezuara-nuk-ishin-te-plota>

¹⁰⁸ https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi_Tetor-2022-KShH.pdf

Me synim garantimin e standardeve minimum të lirisë së medias, KShH kërkoi nga KLP rishikimin e Rregullores së Komunikimit me Median, duke shmangur cënimin e aksesit të gazetarëve në informacion.¹⁰⁹

Në disa raste, KShH ka reaguar publikisht në mbrojtje të lirisë së medias dhe hetimit të shpejtë dhe efektiv të sulmeve sikurse ishte sulmi mafioz në drejtim të godinës së Top Channel, si rrjedhojë e të cilit humbi jetën një viktimë e pafajshme pjesë e stafit të ruajtjes së sigurisë së këtij Televizioni¹¹⁰. Pavarësisht se kanë kaluar rreth 11 muaj nga kjo ngjarje e rëndë, autorët e kësaj ngjarjeje të rëndë nuk rezultojnë të jenë identifikuar.

Barometri Kombëtar për Lirinë e Medias, evidentoi se informaliteti në radhët e punonjësve të medias ka pësuar një ulje të vogël në krahasim me një vit më parë, se punëdhënësit në sektor nuk respektojnë kërkesat ligjore të Kodit të Punës, veçanërisht sa i përket raportit midis ditëve të punës dhe atyre të pushimit. KShH vlerëson se përpjekjet për organizimin sindikal nuk janë konkretizuar ndërkohë që gazetarët pranojnë se ndihen të frikësuar nga punëdhënësit e tyre dhe efektet që do të krijonte ky organizëm në marrëdhëniet e tyre aktuale të punës.

Në sajë të përfaqësimit ligjor të 3 punonjësve të medias gjatë viteve 2022-2023, KMD konstatoi se shoqërimi nga punonjësit e policisë të një gazetari pranë Komisarariatit Lezhë kishte ndodhur për shkaqe diskriminuese. Kufizimi i të drejtës dhe lirisë së ushtrimit të profesionit ndaj gazetarit Xh.M. nga ana e forcave të Policisë, u konstatua i paligjshëm nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e cila vendosi dëmshpërblimin e tij për dëmin jopasuror moral të përjetuar. Gjithashtu, vendimmarrja e Prokurorisë Tiranë për mosfillimin e procedimit penal ndaj disa punonjësve të Policisë Bashkiake dhe funksionarë të tjerë të paidentifikuar, të cilit kishin ushtruar dhunë ndaj gazetares S.M dhe ekipit të xhirimit, pasi u ankimua në gjykatë, ka sjellë së fundmi një zhvillim pozitiv në Gjykatën e Apelit Tiranë në favor të gazetares.¹¹¹

Në dhjetor 2023, KShH reagoi publikisht lidhur me kontrollin personal të gazetarit Elton Qyno, banesës së tij si dhe të zyrave të TV “ORA NEWS” ku ai punon, si dhe për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike dhe mjeteve të tij të punës me kërkesën e SPAK dhe vendimin e GJKKO¹¹², duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së burimeve gazetareske dhe zbatimin e standardit ndërkombëtar të elaboruar nga GJEDNJ, në raste të tjera kundër Shqipërisë.

16 Përfaqësimi ligjor falas i shtetasve pranë Gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare

¹⁰⁹ <https://ahc.org.al/deklarate-per-shtyp-rregullorja-e-keshillit-te-larte-te-prokurorise-cenon-standartet-minimum-te-lirise-se-shprehjes/>

¹¹⁰ <https://ahc.org.al/deklarate-per-shtyp-sulmi-ndaj-top-channel/>

¹¹¹ Gazetaria S.M. së bashku me ekipin e Ora News, të identifikuar me logot përkatëse, duke raportuar nga zona e “5 Majit” në Tiranë, prishjen e banesave, u dhunuan nga policia bashkiake dhe punonjës të tjerë shtetërorë. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë vendosi “Mosfillimin e procedimit penal”. Kundër këtij vendimi, avokatët e KShH depozituan ankim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë i cili u pranua. Prokuroria ka ushtruar ankim mbi këtë vendim, por Gjykata e Apelit Tiranë e rrëzoi atë dhe vendosi kthimin e çështjes për hetime të mëtejshme, me detyra konkrete ndaj organit të akuzës.

¹¹² <https://ahc.org.al/deklarate-per-shtyp-6/>

KShH me anë të stafit avokator ka përfaqësuar një sërë çështjesh të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, me fokus mjedisin, të drejtën e informimit, të drejtat e gazetarëve, të drejtat e personave të privuar nga liria, barazinë dhe mbrojtjen nga diskriminimi, veçanërisht të Komunitetit Rom dhe LGBTIQ, etj. Në disa raste, kontributi i dhënë ka ndihmuar jurisprudencën gjyqësore për të vendosur standarte të mira në trajtimin e çështjeve të veçanta, si model pozitiv orientues për çështje të ngjashme.

Përfaqësimi i çështjeve përpara gjykatave vendase e ka përballur KShH-në me një sërë sfidash. Për shkas të vakancave në sistemin gjyqësor, stokut të çështjeve dhe numrit të rasteve të reja të regjistruara për gjykim, vërehet se gjykimi i çështjeve zgjat në kohë, duke tejkaluar afatet e arsyeshme ligjore. Ky është një element i cili krahas shkeljes së të drejtave të njeriut, prek besimin e qytetarëve tek drejtësia. Mekanizmat e krijuar në bazë të ligjit nr. 111/2017¹¹³ për shpërblimin e shërbimeve të ofruar nga ekspertë, në çështjet në të cilat Gjykata pranon kërkesën për përjashtimin e paditësit nga taksat dhe tarifat gjyqësore, janë sfiduar nga kërkesa e ekspertëve për parapagim. Ky hendek ligjor, bëri që ekspertët të refuzonin përmbushjen e detyrës së ngarkuar,¹¹⁴ duke dështuar zhvillimin brenda afateve të arsyeshme ligjore të seancave të planifikuara nga Gjykata.

KShH vëren me shqetësim vonesat në ekzekutimin apo mosekzekutim të plotë të vendimmarrjeve të Gjykatës, të formës së prerë, të dhëna si nga gjykatat vendase dhe ato të GJEDNJ-së. Kjo problematikë shtrihet si në aspektin procedural¹¹⁵, ashtu edhe në pjesën materiale të disponimit të gjykatave më vendim¹¹⁶. Rrjedhimisht, mbrojtja që KEDNJ ofron nuk ka qenë plotësisht efektive duke cenuar në nivelin më të lartë të mbrojtjes pranë Gjykatës së Strasburgut, të drejtën për një proces të rregullt.

Në nivelin e mbrojtjes gjyqësore pranë gjykatave vendase, e drejta për një proces të rregullt është cenuar si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimmarrjeve gjyqësore me impakt për interesin publik, si mbi ndotjen mjedisore në Lumin Tërkuzë në Kamëz e Gjanicë në Fier, nuk i shërben garantimit të një procesi të rregullt ligjor për qytetarët e dëmtuar.¹¹⁷ Ankimet e realizuara nga ana e institucioneve publike që nuk pranojnë detyrat e tyre funksionale dhe organike, kanë sjellë vonesa në rivendosjen e

¹¹³ Ligji “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

¹¹⁴ Në çështjen e furnizimit me ujë të pijshëm në lagjen ‘Kastriot’ Fushë Krujë, gjatë shqyrtimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ekspertja psikologe e thirrur nga Gjykata, refuzonte kryerjen e akt-ekspertimit, me argumentimin se nuk paguhej në kuadër të ndihmës juridike falas. Ndërkohë, në rastin e shqyrtimit të çështjes, me objekt dëmshpërblimi civil ndaj të dëmtuarit V.G të dhunuar më herët në I EVP Peqin, u vërejt një problematikë e ngjashme nga ekspertët mjeko-ligjorë, e cila u bë shkak për vonesën.

¹¹⁵ KShH monitoroi ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ *Prizreni* kundër Shqipërisë, *Strazimiri* kundër Shqipërisë dhe *Zaharia* kundër Shqipërisë ku rezultoi se VKM për akordimin e dëmshpërblimit janë miratuar pas një vonesë të paarsyeshme e cila vijon nga 1 viti e 5 muaj deri në 3 vjet e 3 muaj.
<https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/08/Raport-Alternativ-Ekzekutimi-i-vendimeve-te-GJEDNJ-ndaj-Shqiperise.pdf>

¹¹⁶ I tillë është rasti i mos ngritjes së një institucioni të posaçëm mjekësor ku të ekzekutohen masat mjekësore (*rasti Strazimiri*), por edhe ofrimi i trajtimit të përshtatshëm shëndetësor (*rasti Zaharia*).

¹¹⁷ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pranoi kërkimet e KShH-së, duke detyruar Bashkinë Kamëz për kryerjen e disa veprimeve administrative, ndër të cilat informimi i AKM-së për dëmin e shkaktuar nga ndotja.

të drejtës së cënuar.¹¹⁸ Risi në praktikën gjyqësore, për çështjet mjedisore të përfaqësuara apo inicuar nga KShH, është standarti i vendosur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë mbi shtrirjen e legjitimitetit aktiv për t'ju drejtuar gjykatës nga çdokush, qoftë person fizik apo juridik, që kujdeset për mjedisin dhe mbrojtjen e tij (duke përfshirë dhe organizatat jofitimprurëse).

KShH vlerëson pozitivisht se në rastet e çështjeve ndaj shtetit Shqiptar pranë GJEDNJ-së, vendimet e kësaj të fundit për çështje të njëjta¹¹⁹ ose të ngjashme,¹²⁰ me atë objekt gjykimi janë mbajtur në konsideratë me fuqinë e precedentit nga sistemi gjyqësor vendas.

Praktikat pozitive të krijuara nëpërmjet litigimit strategjik (mbrojtjes së interesit publik) nga avokatët e Klinikës Ligjore të KShH-së pranë Gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare, kanë shërbyer për promovimin e standardeve më të mira në sistemin e brendshëm gjyqësor. Në mungesë të një institucioni të posaçëm mjekësor, u arrit të promovohet rëndësia e zbatimit të mjekimit ambulator të detyruar pranë instancave komunitare, në vend të masës mjekësore të mjekimit të detyruar në një institucion të natyrës penitenciare.

¹¹⁸ Në një nga rastet është realizuar e drejta e ankimit për shkak të vendimmarrjes së Gjykatës e cila vendoste “informimin e AKM-së (një institucion tjetër) për dëmin e shkaktuar nga ndotja”.

¹¹⁹ Vendimi nr. 18, datë 15.07.2021 i Gjykatës së Lartë i cili pasoi vendimin Strazimiri kundër Shqipërisë të GJEDNJ

¹²⁰ Gjykata Administrative e Apelit vendosi se akomodimi i shtetasve me masë mjekësore në burgje përbën diskriminim duke urdhëruar institucionet përgjegjëse që të zbatonin në mënyrë të menjëherëshme masën mjekësore të vendosur ndaj shtetasit A.B në një institucion mjekësor psikiatrik.